



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 283 Akti

Nr. 413 Vendimi  
Tiranë, më 7.7.2021

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	Kryesuese
<b>Pamela Qirko</b>	Relatore
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 23.6.2021, ora 12:30 dhe në datën 30.6.2021, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Ervin Karanxha**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3, si dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) në datën 15.3.2019 zhvilloi procedurën e shortit për shpërndarjen e çështjeve në trupa gjyqësore, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjyqësor nr. 4, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Xhensila Pine dhe Valbona Sanxhaktari. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Xhensila Pine. Anëtar zëvendësues, sipas shortit, u përzgjedh komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjyqësor të datës 20.3.2019, u caktua me mirëkuptim kryesuese, komisionere Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjyqësor, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Karanxha.

5. Bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Në vijim, komisionere Xhensila Pine ka paraqitur kërkesë për dorëheqje nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, me qëllim shmangien, qoftë edhe në dukje, të cenimit të paanësisë dhe të konfliktit të interesit për shkak se ka qenë anëtare e shortuar (shorti i muajit nëntor të vitit 2018) për procesin e rivlerësimit për subjektin B.K, bashkëshortja e z. Ervin Karanxha. Kjo kërkesë u shqyrtua dhe u pranua nga një tjetër trup gjyqësor<sup>1</sup>. Si rrjedhojë, pjesë e trupit gjyqësor për procesin e rivlerësimit të subjektit Ervin Karanxha, në cilësinë e relatores, u bë anëtarja zëvendësuese Pamela Qirko, e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit.

7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmerisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.

8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40

---

<sup>1</sup> Vendim i datës 19.7.2019, i trupit gjyqësor të përbërë nga komisionarët Suela Zhegu, Roland Ilia dhe Olsi Komici.

të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**10.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”).

**11.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja dërgoi raportin<sup>2</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Karanxha. Në përfundim të veprimeve verifikuese për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka veprime fiktive dhe mashtrim për përfitime të padrejta;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite;*
- *ka kryer deklarim të rremë; dhe*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

**12.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>3</sup> e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ervin Karanxha.

**13.** Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale pranë KLP-së ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësim, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport<sup>4</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**14.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale.

**15.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 12.5.2021 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Karanxha; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**16.** Gjithashtu, po në datën 12.5.2021, subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo për të kërkuar marrjen e provave të reja ose thirrjen

<sup>2</sup> Aktkontrolli nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2018.

<sup>3</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017.

<sup>4</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020.

e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 20.5.2021.

**17.** Në datën 24.5.2021 subjekti i rivlerësimit depozitoi në rrugë elektronike (*me e-mail*) kërkesën për shtyrjen e afatit të përcaktuar për dorëzimin e shpjegimeve dhe provave për të kundërshtuar rezultatet e hetimit, kërkesë e cila u pranua nga Komisioni. Subjektit iu caktua afat i ri për dërgimin e prapësimeve, deri në datën 7.6.2021.

**18.** Në vijim, në datën 7.6.2021, nëpërmjet postës elektronike, si dhe në datën 8.6.2021 me materialet e depozituara në protokollin e Komisionit<sup>5</sup>, subjekti ushtroi të drejtën e prapësimeve, si dhe kërkoi përjashtimin e anëtarit të trupit gjykues, komisionere Valbona Sanxhaktari dhe shtyrjen e afatit përfundimtar të dorëzimit të provave dhe shpjegimeve për të kundërshtuar rezultatet e hetimit.

**18.1.** Në datën 7.6.2021 Komisioni vendosi të pranojë kërkesën e subjektit për shtyrjen e afatit për të depozituar provat dhe shpjegimet, duke i dhënë kohë deri në datën 16.6.2021. Gjithashtu, me anë të këtij vendimi<sup>6</sup> subjekti u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohet në datën 23.6.2021, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*).

**18.2.** Ndërsa kërkesa për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues, komisionere Valbona Sanxhaktari, u shqyrtua në datën 8.6.2021 nga një tjetër trup gjykues, i cili vendosi mospranimin e saj<sup>7</sup>.

**19.** Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 16.6.2021. Gjithashtu, subjekti kërkoi thirrjen e disa dëshmitarëve, kërkesë e cila, me vendimin e datës 18.6.2021, u refuzua nga trupi gjykues<sup>8</sup>.

## **II. SEANCAT DËGJIMORE**

**20.** Seanca e parë dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 23.6.2021, ora 12:30, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0 (*undeground*), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

**20.1.** Në seancën dëgjimore të datës 23.6.2021 subjekti i rivlerësimit nuk ishte prezent, por u përfaqësua me prokurë<sup>9</sup> nga avokatët N.P<sup>10</sup> dhe K.R<sup>11</sup>. Pasi trupi gjykues u tërhoq në dhomë këshillimi dhe verifikoi aktin dhe tagrat e përfaqësimit për dy përfaqësuesit e përcaktuar në këtë akt, vendosi<sup>12</sup> të vijojë me seancën dëgjimore dhe prezantimin e rezultateve të hetimit.

**20.2.** Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore përfaqësuesit e subjektit të rivlerësimit depozituan kërkesë për shtyrjen e seancës dëgjimore – me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ishte në pamundësi për të qenë i pranishëm në seancë për arsye shëndetësore, me gjithë gatishmërinë e tij për të qenë prezent dhe për të dhënë vetë shpjegimet lidhur me rezultatet e hetimit.

<sup>5</sup> Protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2021.

<sup>6</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 7.6.2021.

<sup>7</sup> Vendim i datës 8.6.2021, i trupit gjykues të zgjedhur me short në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 7.6.2021, të Komisionit, të përbërë nga anëtarët Suela Zhegu, Lulzim Hamitaj dhe Roland Ilia.

<sup>8</sup> Vendim i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 18.6.2021.

<sup>9</sup> Prokura e Posaçme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.6.2021.

<sup>10</sup> Avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, pajisur me nr. licence \*\*\*.

<sup>11</sup> Avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, pajisur me nr. licence \*\*\*.

<sup>12</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 23.6.2021.

**20.2.1.** Pasi trupi gjykues u tërhoq në dhomë këshillimi për të shqyrtuar kërkesën e depozituar nga përfaqësuesit e subjektit të rivlerësimit, vendosi<sup>13</sup> të vijojë me seancën dëgjimore prezantimin e rezultateve të hetimit dhe t'i rezervojë subjektit të drejtën për të paraqitur shpjegimet e tij në seancën dëgjimore të datës 30.6.2021, ora 13:00, në po të njëjtën sallë.

**20.3.** Në vijim të seancës dëgjimore të datës 23.6.2021, përfaqësuesit e subjektit të rivlerësimit depozituan kërkesën për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues, komisionere Valbona Sanxhaktari, duke paraqitur si shkak mospërmbushjen prej saj të kriterëve ligjore për të qenë anëtare e institucioneve të rivlerësimit.

**20.3.1.** Pasi u tërhoq në dhomë këshillimi, verifikoi dhe vlerësoi këtë kërkesë, trupi gjykues vërejti se kërkesa nuk gjen mbështetje në parashikimet e bëra në nenin 27 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili referon nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative dhe, për këtë arsye, me shumicë votash, vendosi<sup>14</sup> mospranimin e kërkesës dhe vijimin e seancës dëgjimore.

**20.4.** Gjithashtu, gjatë kësaj seance përfaqësuesit e subjektit depozituan kërkesë tjetër për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues, znj. Valbona Sanxhaktari.

**20.4.1.** Pasi u tërhoq në dhomë këshillimi, verifikoi dhe analizoi këtë kërkesë, trupi gjykues vlerësoi se duhet të shqyrtohej në kuptim të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, interpretuar së bashku me nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative dhe, për këtë arsye, vendosi<sup>15</sup> ndërprerjen e seancës dëgjimore, me qëllim paraqitjen e kësaj kërkesë për shqyrtim një tjetër trupi gjykues. Seanca e radhës do të njoftohej edhe nëpërmjet postës elektronike, si dhe në faqen zyrtare të Komisionit.

**20.4.2.** Kërkesa për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues, znj. Valbona Sanxhaktari, u shqyrtua në datën 24.6.2021 nga një tjetër trup gjykues, i cili vendosi mospranimin e saj<sup>16</sup>.

**21.** Seanca e radhës dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 30.6.2021, ora 13:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

**21.1.** Në seancën dëgjimore të datës 30.6.2021 subjekti i rivlerësimit nuk ishte prezent dhe u përfaqësua sërish nga avokatët N.P dhe K.R, të cilët sipas aktit të përfaqësimit kishin tagra vetëm të paraqisnin kërkesa në emër të subjektit të rivlerësimit.

**21.2.** Gjatë zhvillimit të kësaj seance dëgjimore përfaqësuesit e subjektit të rivlerësimit depozituan: 4 (katër) kërkesa për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues, znj. Valbona Sanxhaktari; 2 (dy) kërkesa për përjashtimin e anëtares së trupit gjykues, znj. Etleda Çiftja; si dhe 2 (dy) kërkesa për pezullimin e gjykimit të çështjes objekt rivlerësimi, deri në përfundimin me vendim të formës së prerë të çështjeve penale, për sa u përket kallëzimeve të bëra nga shoqata “A.A.SH”, ndaj anëtarëve të trupit gjykues Valbona Sanxhaktari dhe Etleda Çiftja.

**21.2.1.** Trupi gjykues, pasi u tërhoq në dhomë këshillimi, shqyrtoi dhe vlerësoi kërkesat e sipërcituara, vendosi<sup>17</sup>:

<sup>13</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 23.6.2021.

<sup>14</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 23.6.2021.

<sup>15</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 23.6.2021.

<sup>16</sup> Vendim i datës 24.6.2021, i trupit gjykues të zgjedhur me short në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 23.6.2021, të Komisionit, të përbërë nga anëtarët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu.

<sup>17</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 30.6.2021.

- i. Mospranimin e kërkesave për pezullimin e gjykimit, për shkak të kallëzimeve penale të bëra në SPAK ndaj dy anëtarëve të trupit gjykues, nga shoqata “A.A.SH”, si të pabazuara në ligj.
- ii. Administrimin e kërkesave të paraqitura për përjashtimin e dy anëtarëve të këtij trupi gjykues dhe dërgimin e tyre në Komision për t’u shqyrtuar nga një tjetër trup gjykues, të përzgjedhur me short sipas procedurave përkatëse.
- iii. Bazuar në pikën 6 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në paragrafin 6 të nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile, vijimin e kësaj seance dëgjimore, por se anëtarët nuk do të marrin pjesë në dhënien e vendimit, derisa të jepet vendimi lidhur me kërkesën e përjashtimit.

**21.3.** Në vijim të seancës dëgjimore, trupi gjykues, pasi u tërhoq sërish në dhomë këshillimi për të shqyrtuar kërkesën e bërë në mënyrë verbale nga përfaqësuesit ligjorë të subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues – me pretendimin për njëanshmëri në gjykimin e çështjes – vendosi<sup>18</sup>:

- i. Të dërgojë këtë kërkesë për shqyrtim në Komision nga një tjetër trup gjykues dhe se kërkuesi duhet ta paraqesë me shkrim brenda 24 orëve, së bashku me arsyetimin përkatës.
- ii. Bazuar në pikën 6 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në paragrafin 6 të nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile, vijimin e kësaj seance dëgjimore, por se anëtarët nuk do të marrin pjesë në dhënien e vendimit, derisa të jepet vendimi lidhur me kërkesën e përjashtimit.

**21.4.** Pas relatimit të rezultateve të hetimit, në përfundim të seancës dëgjimore të datës 30.6.2021, për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, kryesuesja e trupit gjykues komunikoi se seanca e radhës do të mbahet në datën 7.7.2021, ora 9:30, në të njëjtën sallë. Njoftimi për zhvillimin e kësaj seance u publikua edhe në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nga zyra e IT-së.

**22.** Pasi u vu në dijeni të vendimmarrjes së trupit tjetër gjykues<sup>19</sup>, i cili ka vendosur mospranimin e kërkesave të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, të paraqitura nëpërmjet përfaqësuesve të tij ligjorë në seancën dëgjimore të datës 30.6.2021, për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues Valbona Sanxhaktari dhe Etleda Çiftja, si dhe mospranimin e kërkesës së depozituar me shkrim në Komision në datën 2.7.2021, protokolluar me nr. \*\*\* (kërkesë e shprehur edhe verbalisht në seancën dëgjimore të datës 30.6.2021) për përjashtimin e të gjithë anëtarëve të trupit gjykues – në datën 6.7.2021 trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, u mblodh në dhomë këshillimi, dhe vendosi<sup>20</sup>: (i) të vijojë me procesin e vendimmarrjes për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Karanxha; si dhe (ii) të urdhërojë specialistin e IT-së të bëjë ndryshimet përkatëse në faqen zyrtare të Komisionit, duke pasqyruar se seanca e datës 7.7.2021 do vijojë me shpalljen e vendimit.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**23.** Z. Ervin Karanxha nuk ka qenë gjithmonë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, duke mos iu përgjigjur në mënyrë direkte të gjitha pyetjeve të dërguara gjatë hetimit administrativ apo shpjegimeve të kërkuara me dërgimin e rezultateve të hetimit, si dhe duke mos depozituar në çdo rast dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni.

<sup>18</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 30.6.2021.

<sup>19</sup> Vendimet e datës 2.7.2021, i trupit gjykues të zgjedhur me short në bazë të vendimin të Komisionit me nr. \*\*\*, datë 29.6.2021, përbërë nga anëtarët Roland Ilia, Suela Zhegu dhe Lulzim Hamitaj.

<sup>20</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. \*\*\*, datë 6.7.2021.

**23.1.** Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kërkesave procedurale të shumta dhe të përsëritura, ka synuar zvarritjen e procesit, në kushtet kur Komisioni i ka garantuar të gjitha të drejtat për një proces të rregullt ligjor – madje duke i dhënë kohë të mjaftueshme shtesë për të paraqitur provat dhe shpjegimet e tij në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**24.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë.

**24.1.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë të përcaktuara qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**24.2.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**24.3.** Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**24.4.** Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**24.5.** Por, referuar vendimit nr. 2/2017<sup>21</sup>, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**25.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit

---

<sup>21</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale, të dorëzuar në Komision nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**26.** Pas administrimit të raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së tij. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive.

**26.1.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në këtë institucion, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Karanxha.

**26.2.** Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

**27. Pasuria e llojit “apartament”<sup>22</sup>** me sipërfaqe 90.12 m<sup>2</sup>, me vlerë 8,200,000 lekë, ndodhur në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, porositur nga shoqëria “Sh” sh.p.k., me kontratën e sipërmartjes së datës 1.10.2011. Subjekti ka deklaruar se zotëron 50 % të kësaj pasurie.

**27.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (i) kredinë e marrë në BKT, me afat 25-vjeçar, në shumën 5,000,000 lekë; si dhe (ii) kursimet familjare në vite.

### **Deklarimi i pasurisë në vite**

**27.2.** Referuar deklaratës së interesave private/periodike vjetore (në vijim “DIP”) të vitit 2011 të depozituar në ILDKPKI, konstatohet se subjekti ka deklaruar kontratë noteriale (sipërmarrjeje) me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.10.2011, për apartamentin nr. \*\*\*, kati \*\*\*, me sip. 90.12 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, vlera e blerjes 8,200,000 lekë.

**27.3.** Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është blerë me shumën e siguruar nga revokimi i kontratës së sipërmartjes së mëparshme me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol. (kredia e marrë në BKT në vlerat 5,000,000 lekë dhe 1,000,000 lekë) dhe nga kursimet familjare dhe personale ndër vite.

**27.4.** Lidhur me mënyrën dhe planin e pagesave, subjekti ka deklaruar se në momentin e lidhjes së kontratës është paguar shuma prej 5,000,000 lekësh. Në vijim, në datën 25.10.2011 është likuiduar shuma 2,000,000 lekë dhe në datën 28.11.2011 është likuiduar shuma 1,200,000 lekë. Në datën 28.11.2011 porositësi dhe sipërmarrësi kanë nënshkruar një deklaratë, duke deklaruar se nuk kanë detyrime ndaj njëri-tjetrit. Pagesa është bërë kredi BKT + kursime familjare dhe personale.

---

<sup>22</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI): (i) aktmarrëveshje - kontratë sipërmarrjeje, me vërtetim nënshkrimi i datës 1.10.2011 dhe dokumentacionin shoqërues të saj; (ii) kopje mandatpagesash, datë 1.10.2011, në vlerën 5,000,000 lekë; datë 25.10.2011, në vlerën 2,000,000 lekë dhe; datë 28.11.2011, në vlerën 1,200,000 lekë.



## **Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri dhe burimet e krijimit të saj**

**27.5.** Nga verifikimi i përgjigjeve të ardhura nga ASHK-ja, rezulton se kjo pasuri nuk figuron ende e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur.

**27.6.** UKT-ja<sup>23</sup> konfirmon kontratë në emër të personit të lidhur, znj. B.K, me status aktiv, me adresë: rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, e cila përkon me adresën e apartamentit objekt vlerësimi.

**27.7.** OSHEE-ja<sup>24</sup> konfirmon abonent me kontratë furnizimi në emrin e personit të lidhur, znj. B.K (bashkëshortja e subjektit), me datë hapjeje 2.8.2011. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga OSHEE-ja duket se kjo kontratë e tipit familjar i përket adresës: rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, apartamenti \*\*\* Tiranë, e cila përkon me adresën e apartamentit objekt vlerësimi.

**27.8.** Pra, rezulton se kontrata për furnizim me energji elektrike është hapur në emër të personit të lidhur rreth 2 muaj para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “Sh” sh.p.k.

**27.9.** Si rrjedhojë, Komisioni konstaton se marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit/personit të lidhur me shoqërinë “Sh” sh.p.k., ka filluar para datës 1.10.2011 (data e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes).

**27.10.** Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të japë shpjegime lidhur me faktin e hapjes së kësaj kontrate në emër të personit të lidhur – para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “Sh” sh.p.k., të deklarojë mbi çfarë dokumentacioni është hapur kjo kontratë, të depozitojë kontratën e lidhur mes bashkëshortes dhe OSHEE-së, si dhe ekstraktin e pagesave të kryera për periudhën 2.8.2011 – 31.12.2012.

**27.11.** Nëpërmjet prapësimeve të dërguara, subjekti ka parashtruar se kontrata e sipërmarrjes, datë 1.10.2011, është bërë draftkontratë që në korrik të vitit 2011 dhe në cilësinë e një kontrate premtimi sipërmarrjeje ka shërbyer që bashkëshortja të fillojë negociatat për revokimin e kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.5.2011, për blerje apartamenti me sip. 114.5 m<sup>2</sup> në Berat, për vlerën 6,000,000 lekë. Kjo kontratë është revokuar nëpërmjet deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.9.2011, duke bërë të mundur edhe kthimin e vlerave financiare, nga të cilat shuma prej 5,000,000 lekësh është kryer si pagesë e kështit të parë në datën 1.10.2011, në drejtim të shoqërisë “Sh” sh.p.k. Shoqëria ndërtuese në gusht të vitit 2011 ka qenë në fazën e pajisjes së ambienteve të shërbimeve dhe apartamenteve të ndërtesës me librezat përkatëse të energjisë dhe ujit dhe në këtë kohë shoqëria, duke e marrë të mirëqenë dhënien e dakordësisë në lidhje me prenotimin e tyre, i ka nxjerrë librezat në emër të bashkëshortes së tij.

**27.12.** Subjekti ka argumentuar se konstatimi i bërë nga Komisioni nuk është i saktë, duke pretenduar se referuar faturave të energjisë elektrike për periudhën janar 2011 – dhjetor 2012 është lehtësisht e verifikueshme se shumatat e faturuara deri në nëntor të vitit 2012 janë në vlera të vogla, të cilat në vijim rriten, pasi në atë periudhë kanë filluar të banojnë në këtë apartament.

**27.13.** Në analizë të shpjegimeve të dhëna, trupi gjykues çmoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i qartë në prapësimet e tij, pasi Komisioni në asnjë rast nuk vuri në dyshim që të ketë filluar të banojnë në apartamentin objekt vlerësimi që në momentin e lidhjes së kontratës së energjisë elektrike në emër të bashkëshortes së tij, por se nga hetimi i kryer rezultoi se kontrata për energjinë elektrike për këtë pasuri të jetë lidhur në emër të bashkëshortes përpara nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “Sh” sh.p.k. Nisur nga kjo rrethanë, Komisioni konstatoi se marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur me shoqërinë “Sh” sh.p.k. ka nisur para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes.

<sup>23</sup> Me shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2019.

<sup>24</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2019.

**27.14.** Komisioni vëren se vetë subjekti i rivlerësimit ka pranuar se marrëdhënia me shoqërinë “Sh” sh.p.k. ka filluar para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, duke pretenduar se ajo e datës 1.10.2011 të jetë bërë si draft që në korrik të vitit 2011.

**27.15. Si konkluzion,** trupi gjykues çmon se subjekti nuk shpjegoi bindshëm mospërputhjen që ekzistonte midis datës së kontratës së sipërmarrjes (1.10.2011) nga njëra anë dhe datës së lidhjes së kontratës me OSHEE-në (2.8.2011) nga ana tjetër, duke marrë në konsiderate se lidhja e kontratës me OSHEE-në, sipas legjislacionit të kohës ka pjesë përbërëse edhe një kopje të dokumentit të pronësisë, qirasë apo sipërmarrjes, me qëllim lidhjen e kontratës së furnizimit me energji elektrike. Për rrjedhojë, pretendimi i subjekti se shoqëria ndërtuese vendosi të dërgojë emrin e bashkëshortes për ta pajisur me librezë energjie elektrike para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes ndërmjet tyre, është i pabazuar në ligj dhe në prova. Në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar trajtim preferencial në marrëdhënien e tij me shoqërinë “Sh” sh.p.k., trupi gjykues çmon se nuk gjen shpjegim tjetër vetëbesimi i tepruar i treguar nga kjo shoqëri për të pranuar lidhjen e kontratës së energjisë elektrike në emër të personit të lidhur, znj. B.K, para nënshkrimit të sipërmarrjes, përveçse ekzistencës së ndonjë kontrate të fshehur dhe/apo marrjes së pagesave paraprake lidhur me këtë pasuri. Në këtë këndvështrim, nga analiza në harmoni e provave të administruara në dosje, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe rrethanave të pasqyruara si më sipër, trupi gjykues ngre dyshime të arsyeshme se pagesa e kështit të parë prej 5,000,000 lekësh për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi të jetë kryer që në korrik të vitit 2011 dhe se ky fakt të jetë fshehur nga subjekti i rivlerësimit me qëllim shmangien e kontrollit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj dhe interesave private që lidhen me të, duke u gjendur në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

#### **Analiza e të ardhurave të deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie**

**28.** Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie: (i) kredinë e marrë në BKT, me afat 25-vjeçar, në shumën 5,000,000 lekë; si dhe (ii) kursimet familjare në vite. Ndërsa, në DIP-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është blerë me shumën e siguruar nga revokimi i kontratës së mëparshme të sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol. (kredia e marrë në BKT në vlerat 5,000,000 lekë dhe 1,000,000 lekë) dhe nga kursimet familjare dhe personale ndër vite. Ndërsa, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kredi bankare të marrë në BKT për shumën 5,000,000 lekë, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.7.2011.

**28.1.** Gjithashtu, Komisioni vëren se në DIP-në e vitit 2011 subjekti ka deklaruar kontratë porosie (sipërmarrjeje) nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.5.2011, për blerje apartamenti me sip. 114.5 m<sup>2</sup> në Berat, për vlerën 6,000,000 lekë. Lidhur me planin e pagesave ka deklaruar se nga porositësi është likuiduar në fillim shuma prej 1,000,000 lekësh, ndërsa pjesa tjetër e mbetur e detyrimit (shuma prej 5,000,000 lekësh) është paguar nga kredia bankare e marrë në BKT (e marrë nga porositësi në shumën 5,000,000 lekë). Në vijim të deklaramit, subjekti ka sqaruar se nëpërmjet deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.9.2011, është bërë revokimi i kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.5.2011 dhe, si rrjedhojë, porositësi ka dorëzuar tek sipërmarrësi apartamentin prej 114.5 m<sup>2</sup> të ndodhur në Berat, ndërsa sipërmarrësi ka kthyer shumën 6,000,000 lekë tek porositësi.

**28.2.** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me apartamentin e porositur në Berat, për mënyrën e likuidimit të çmimit, burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e tij, shkakun e revokimit të kontratës së porosisë, mënyrën e kthimit të shumës nga sipërmarrësi dhe destinacionin e saj, ndër të tjera, ka deklaruar se *përgjatë viteve 2004 - 2008 bashkëshortja e tij ka ushtruar detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe nga prilli i vitit 2008 deri në datën 16.7.2013 ka qenë me funksion kryetare e kësaj gjykate. Në këtë kuptim, për shkak të ushtrimit të detyrës në qytetin e Beratit, ajo ka përfutuar kredi, nga ku detyrimi parësor që duhet të përmbushte në plotësim të kritereve kishte të bënte me*

provueshmërinë e faktit se nuk kishte një tjetër banesë në qytetin e Beratit. Ky fakt është provuar dhe, si rrjedhojë, është mundësuar edhe marrja dhe disbursimi i kredisë. Bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore kjo kredi është marrë me kushte lehtësuese, duke u paguar interes 4 %. Sipas statement-it të BKT-së kredia është disbursuar në llogarinë e bashkëshortes në vlerën 4,950,000 lekë, e cila i ka kaluar shtetasit J.L.T për blerje apartamenti. Në përmbushje të destinacionit/qëllimit të marrjes së kredisë, me kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 27.5.2011, është porositur apartament me sip. 114.5 m<sup>2</sup>, në vlerën 6,000,000 lekë, me adresë: lagjia “\*\*\*”, Berat, fakt i deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2011. Për këtë kontratë porosie fillimisht është likuiduar shuma prej 1,000,000 lekësh (kursime familjare ndër vite) në favor të këtij shtetasi, nëpërmjet bankës në datën 27.5.2011.

**28.3.** Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se nga komunikimi verbal me palën kontraktuese të kontratës së porosisë i është kërkuar që të depozitonin shumën prej 250,000 lekësh përpara disbursimit të kredisë, për shkaqe financiare të kësaj shoqërie dhe kanë rënë dakord verbalisht që kjo shumë do të zbritet nga shuma totale e kredisë që banka do të kalonte për llogari të kësaj kontrate porosie tek shoqëria përkatëse. Në datën 20.6.2011, nëpërmjet bankës, është kryer pagesa prej 250,000 lekësh (kursime familjare) për llogari të kontratës së porosisë së vitit 2011 dhe në këtë moment i kanë kërkuar bankës që nga shuma totale prej 5 milionë lekësh e kredisë së marrë në BKT, në momentin që do të kalonte në llogarinë bankare të shoqërisë të zbritet shuma prej 250,000 lekësh, pasi vlera totale e pagesës së apartamentit ishte 6,000,000 lekë. Në datën 22.7.2011 banka ka kaluar në llogari të firmës shumën 4,900,000 lekë, pa kryer zbritjen e shumës së paguar më parë prej 250,000 lekësh. Për këtë veprim janë vënë në dijeni nga pala kontraktuese, pasi ka kaluar shuma përkatëse e kredisë, por meqenëse ishin në bisedime për revokimin e kontratës së porosisë, ranë dakord verbalisht që e gjithë shuma do të kthehet në momentin e revokimit të kontratës së porosisë para noterit.

**28.4.** Nga verifikimi i dokumentacionit bankar rezultoi se në datën 21.7.2011 në llogarinë e personit të lidhur në BKT është disbursuar kredia prej 4,950,000 lekësh dhe se në datën 22.7.2011 nga kjo llogari është transferuar në favor të shtetasit J.T shuma prej 4,900,000 lekësh, me përshkrimin “B.B.K kalon në favor të J.L.T pagesë për blerje apartamenti me nr. kontrate \*\*\* kol., \*\*\*, datë 27.5.2011”.

**28.5.** Referuar deklarimeve të bëra, si dhe dokumentacionit të administruar në dosje dhe të depozituar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, pagesat për blerjen e apartamentit në Berat janë kryer, të pasqyruara në tabelën si vijon:

**Tabela nr. 1.**

Data	Vlera	Dokumentacioni
27.5.2011	1,000,000	Depozitim cash në BKT për J.T
20.6.2011	250,000	Depozitim cash në BKT për J.T
22.7.2011	4,900,000	Transfertë në BKT për J.T
	<b>6,150,000</b>	

**28.6.** Në vijim, subjekti ka shpjeguar se bashkëshortja e tij ka revokuar kontratën e porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 27.5.2011, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep. nr. \*\*\* kol., datë 16.9.2011 (rreth 4 muaj pas nënshkrimit të kontratës së porosisë) dhe se kthimi i këtyre vlerave është bërë sipas mandatpagesës nr. \*\*\*, datë 16.9.2011, në momentin e revokimit të kontratës.

**28.7.** Referuar mandatpagesës – kopje e së cilës është depozituar si provë nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në datën 16.9.2011 – personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit, i është kthyer shuma prej 6,150,000 lekësh si rezultat i revokimit të kontratës për blerje apartamenti, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 16.9.2011.

**28.8.** Komisioni vlerëson se në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin burimin e krijimit të pasurisë objekt vlerësimit (apartamenti në Tiranë), duke qenë se nga hetimi rezultoi se si burim krijimi për pagesën e këtij apartamenti në tetor të vitit 2011 kanë shërbyer të ardhurat nga revokimi i kontratës së sipërmartjes për apartamentin në Berat dhe jo sikundër deklaroi subjekti, kredia 5,000,000 lekë, duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara në germën “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**28.9.** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se në datën 27.5.2011 personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, ka lidhur kontratën e porosisë<sup>25</sup> me investitorin J.T, për apartamentin me sip. 114.5 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Berat, për vlerën 6,000,000 lekë. Referuar kësaj kontrate, me nënshkrimin e saj porositësi pagoi shumën prej 1,000,000 lekësh, ndërsa kësti i fundit prej 5,000,000 lekësh do të shlyhej menjëherë pas disbursimit të kredisë që porositësja do të merrte në çdo bankë të nivelit të dytë.

**28.10.** Ndërkohë, në deklaratimet e bëra gjatë hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se krahas shumës prej 1,000,000 lekësh paguar me lidhjen e kontratës (në datën 27.5.2011), në datën 20.6.2011 është paguar në favor të investitorit J.T edhe shuma prej 250,000 lekësh.

**28.11.** Si rrjedhim, rezulton se deri në datën 20.6.2011 në favor të investitorit J.T, për porositjen e apartamentit në Berat, është paguar në total shuma 1,250,000 lekë. Në referim të deklaratimeve të bëra në DIP-të vjetore dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, kjo shumë e paguar ka si burim kursimet familjare dhe personale të subjektit të rivlerësimit ndër vite.

**28.12.** Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile<sup>26</sup> informon se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me znj. B.K në datën 2.10.2009. Gjithsesi, Komisioni vëren se edhe personi i lidhur, për shkak të funksionit, ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI dhe ka depozituar DIP-të vjetore që i përkasin viteve 2004 e në vijim (për shkak se ka filluar detyrën në vitin në vitin 2004, data e emërimit në detyrë 1.10.2004). Ndërsa, subjekti i rivlerësimit, për shkak se është emëruar në detyrë në datën 1.10.2003, ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI që prej deklaratës fillestare të pasurisë së vitit 2003, e në vijim.

**28.13.** Nga verifikimi i DIP-ve vjetore të depozituara nga bashkëshortja e subjektit ndër vite në ILDKPKI, rezultoi se deri në vitin 2009 nuk ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash*. Ndërsa, referuar DIP-së së vitit 2010 konstatohet se personi i lidhur ka deklaruar shtesë pasurie në formë likuiditetesh *cash* shumën prej 500,000 lekësh. Ndërsa, nga verifikimi i DIP-ve vjetore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, ndër të tjera, konstatohet se:

- i. Në deklaratën fillestare të pasurisë, subjekti ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 4,000 USD, me burim krijimi të ardhurat personale dhe të familjes;
- ii. Në DIP-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar shtesë të likuiditeteve *cash* në shumën 2,000 USD – gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit (datë 31.12.2004) në shumën 6,000 USD;
- iii. Në DIP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar shtesë të likuiditeteve *cash* në shumën 4,000 USD dhe gjendjen e likuiditeteve *cash* në fund të vitit (datë 31.12.2005) në shumën 10,000 USD;
- iv. Në DIP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar: *“Deklarimi i mëparshëm 10,000 USD. Shtuar për vitin 2006 shuma prej 3,000 USD. Pasuria në total: 13,000 USD”*;

<sup>25</sup> Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.5.2011.

<sup>26</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2019.

- v. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar<sup>27</sup> ka rezultuar se në datën 10.8.2006 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në “Emporiki Bank” (sot ABI Bank) shumën 10,000 USD, duke e investuar në depozitë me afat. Gjendja e kësaj depozite në datën 31.12.2006 është 10,000 USD.

**28.14.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se në kundërshtim me parashikimet e bëra në germen “d” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e pasurisë së llojit “likuiditete” në bankë në fund të vitit 2006 dhe as burimin e krijimit të tyre.

**28.15.** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur<sup>28</sup> në lidhje me këtë depozitë bankare dhe burimet e krijimit të saj, ndër të tjera, ka deklaruar se *gjatë plotësimit të deklaratës vjetore ka deklaruar shtesën e likuiditeteve ndër vite, duke qenë koherent me shumat përkatëse. Ka deklaruar rregullisht shumën cash dhe duke qenë se është e njëjta shumë që është depozituar në bankë (jo shumë tjetër nga gjendja cash), nuk e ka deklaruar vetëm për arsyen se është mjaftuar vetëm me deklarin e së njëjtës shumë në gjendjen cash. Përderisa ka deklaruar rregullisht për gjendjen e tij cash ndër vite dhe nuk ka pasur asnjë arsye për të fshehur depozitimin e kësaj shume në bankë.*

**28.16.** Nisur nga fakti i evidentimit të depozitës bankare me gjendje në datën 31.12.2006 në shumën 10,000 USD, në kuptim të ligjit për deklarin dhe kontrollin e pasurive (ligji nr. 9049, datë 10.4.2003), si dhe në referim të deklarin të bërë nga subjekti në DIP-në e vitit 2006, duket se gjatë këtij viti shtesa e likuiditeteve është në total në shumën 13,000 USD, nga të cilat 3,000 USD shtesë likuiditetesh *cash* dhe 10,000 USD shtesë likuiditetesh në bankë.

**28.17.** Sa më sipër, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në konsideratë të faktit që subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar më parë, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për vitin 2006, nga ku duket se subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive (likuiditeteve *cash* + bankë) dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara nga Komisioni, përgjatë vitit 2006.

**28.18.** Në DIP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar shtesë të likuiditeteve *cash* në shumën 6,000 USD. Në DIP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar kursime nga paga për vitin 2008 në shumën 7,000 USD.

**28.19.** Nga verifikimi i dokumentacionit bankar<sup>29</sup> ka rezultuar se në datën 18.7.2008 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në “Raiffeisen Bank” shumën 10,000 USD, duke e investuar në depozitë me afat. Në vijim, konstatohet se në datën 10.10.2008 nga kjo depozitë ka tërhequr shumën prej 8,000 USD. Gjendja e kësaj depozite në datën 31.12.2008 është në shumën 2,000 USD.

**28.20.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se në kundërshtim me parashikimet e bëra në germen “d” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti nuk ka deklaruar gjendjen e pasurisë së llojit “likuiditete” në bankë në fund të vitit 2008 dhe as burimin e krijimit të tyre.

**28.21.** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur<sup>30</sup> në lidhje me këtë depozitë bankare dhe burimet e krijimit të saj, ndër të tjera, ka deklaruar shtesën e likuiditeteve *cash* ndër vite, duke qenë koherent me shumat përkatëse. Ka deklaruar rregullisht shumën *cash* dhe duke qenë se është

<sup>27</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.5.2019, e ABI Bank (ish-“Emporiki Bank”).

<sup>28</sup> Pyetësori nr. 2.

<sup>29</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2019, e “Raiffeisen Bank”.

<sup>30</sup> Pyetësori nr. 2.

*e njëjta shumë që është depozituar në bankë (jo shumë tjetër nga gjendja cash), nuk e ka deklaruar vetëm për arsyen se është mjaftuar vetëm me deklarin e së njëjtës shumë në gjendjen cash. Përderisa ka deklaruar rregullisht për gjendjen e tij cash ndër vite, nuk ka pasur asnjë arsye për të fshehur depozitimin e kësaj shume në bankë.*

**28.22.** Nisur nga fakti i evidentimit të depozitës bankare me gjendje në datën 31.12.2008 në shumën 2,000 USD, në kuptim të ligjit për deklarin e pasurive (ligji nr. 9049, datë 10.4.2003), si dhe në referim të deklarin të bërë nga subjekti në DIP-në e vitit 2008, duket se gjatë këtij viti shtesa e likuiditeteve është në total në shumën 9,000 USD, nga të cilat 7,000 USD shtesë likuiditetesh *cash* dhe 2,000 USD shtesë likuiditetesh në bankë.

**28.23.** Sa më sipër, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në konsideratë të faktit që subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar më parë, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për vitin 2006, nga ku duket se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive (likuiditeteve *cash* + bankë) dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara nga Komisioni, përgjatë vitit 2008.

**28.24.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet përfundimtare dhe të depozitohë prova të reja të mundshme lidhur me mosdeklarin e dy depozitave bankare në valutë – të evidentuara si më sipër, përkatësisht të krijuara në vitet 2006 dhe 2008, si dhe mbi rezultatet e analizës financiare për këto dy vite.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**29.** Komisioni vëren se subjekti i ka qëndruar të njëjtave shpjegime të dhëna gjatë hetimit administrativ lidhur me dy depozitat bankare të krijuara përgjatë viteve 2006 dhe 2008, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se mosdeklarin i tyre në vitet përkatëse nuk ka qenë i qëllimshëm, pasi ka deklaruar ndër vite shtesat e pasurive të llojit “likuiditete”, porse nuk ka deklaruar ndryshimin e vendndodhjes së një pjese të tyre dhe konkretisht se një pjesë të tyre i ka depozituar në bankë.

**29.1.** Si rrjedhojë, subjekti ka kundërshtuar rezultatet e analizës financiare për vitet 2006 dhe 2008, pasi e konsideron të dubluar shtesën e pasurisë për këto dy vite, duke pretenduar se depozitat gjendje në bankë nuk janë pasuri tjetër, por janë pjesë e likuiditeteve të deklaruara në vazhdimësi dhe shtesave në vitin e deklarin. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se në analizën financiare ka ndikuar edhe kursi i këmbimit i aplikuar nga Komisioni.

**29.2.** Në mbështetje të prapësimeve të tij lidhur me analizën financiare, subjekti ka depozituar në rrugë elektronike (me *e-mail*), si provë të re, kopje të raportit të mbajtur nga audituesi ligjor I.D, dokumentin aktekspertim të datës 15.6.2021.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**30.** Lidhur me deklarin e likuiditeteve, referuar nenit 4, pika “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë *vlerën e likuiditeteve, gjendje cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*, si dhe burimin e krijimit të tyre.

**30.1.** Në formularët e deklarin të pasurisë, në seksionin “Deklarimi i interesave private, pasuritë e luajtshme/pasuritë e paluajtshme”, që i përket DIP-së së vitit 2006 dhe në seksionin “Ndryshimet e interesave private, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, që i përket DIP-së së vitit 2008, nga deklaruesit kërkohet që të pasqyrojnë ndryshimet (shtesa dhe pakësime) të ndodhura në interesat pasurorë privatë të deklaruara më parë, për çdo lloj pasurie të luajtshme dhe të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarin.

**30.2.** Nga ana tjetër, Komisioni vëren se në deklaratën fillestare të pasurisë subjekti ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 4,000 USD dhe se në DIP-të e viteve 2004 - 2007 ka deklaruar shtesë likuiditetesh në gjendje *cash*, por se në asnjë rast nuk ka deklaruar pakësimin e tyre dhe, si rrjedhojë, këto shtesa likuiditetesh *cash* nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i dy depozitave të krijuara në vitet 2006 dhe 2008.

**30.3.** Në vijim të sa më sipër, në dritën edhe të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mënyrën e tij të deklarimit të likuiditeteve është jo vetëm në kundërshtim me ligjin, por edhe një pretendim alogjik<sup>31</sup>.

**30.4.** Si përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm apo të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe se analiza ekonomike-financiare në formë tabelare e paraqitur prej tij nuk ka vlerë provuese në drejtim të mënyrës së deklarimit dhe përdorimit të likuiditeteve. Ndërsa, pretendimet e subjektit mbi efektin financiar të kursit të këmbimit vlerësohet se janë të pakonsiderueshme, të tilla që nuk ndikojnë në analizën financiare.

**30.5.** Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit pas rezultateve të hetimit, si dhe pas arsyetimit të kryer mbi mënyrën e deklarimit të likuiditeteve, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë për vitet 2006 dhe 2008, të pasqyruara në tabelat si vijojnë:

**Tabela nr. 2.**

Analiza financiare e vitit 2006	Vlerat në lekë
<b>PASURI</b>	<b>1 444 918</b>
Ndryshim likuiditeti	1 444 918
TOTAL LIKUIDITETE	2 500 655
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>1 444 918</b>
<b>Të ARDHURA</b>	<b>849 687</b>
Të ardhura nga paga ushtrimi i detyrës, subjekti	849 687
<b>SHPENZIME</b>	<b>171 409</b>
Shpenzime jetike	109 557
Shpenzime udhëtimi	61 852
<b>BALANCA E FONDEVE</b>	<b>- 766 640</b>

**Tabela nr. 3.**

Analiza financiare e vitit 2008	Vlerat në lekë
<b>PASURI</b>	<b>982 967</b>
Ndryshim likuiditeti	982 967
TOTAL LIKUIDITETE	3 490 334
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>982 967</b>
<b>Të ARDHURA</b>	<b>878 424</b>

<sup>31</sup> Referohu trajtimit të bërë nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit mbi deklarimin e likuiditeteve, në vendimet: (i) vendimi nr. 7/2019 (JR), në pikat 32.4 dhe 32.5 të paragrafit nr. 32; (ii) vendimi nr. 11/2019 (JR), në pikën nr. 27.12.18 të paragrafit nr. 27; (iii) vendimi nr. 19/2019 (JR), në paragrafin nr. 84; (iv) vendimi nr. 20/2019 (JR), në paragrafin nr. 59; dhe (v) vendimi nr. 29/2019 (JR), në paragrafin nr. 31, etj.).

Të ardhura nga paga ushtrimi i detyrës, subjekti	810 986
Të ardhura nga paga Universiteti UFO, subjekti	32 400
Të ardhura nga interesa bankare (“Emporiki Bank”)	35 038
<b>SHPENZIME</b>	<b>136 620</b>
Shpenzime jetike	136 620
<b>BALANCA E FONDEVE</b>	<b>- 241 163</b>

**30.6.** Si përfundim, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin dhe se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive (likuiditeteve *cash* + bankë) dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara nga Komisioni përgjatë viteve 2006 dhe 2008, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga germa “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**30.7.** Në vijim konstatohet se në DIP-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 215,000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga pagat. Ndërsa, referuar DIP-së së vitit 2010, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja në ILDKPKI, konstatohet se kanë deklaruar veçmas – secili shtesë pasurie në shumën 500,000 lekë – në total shumën prej 1,000,000 lekësh, me burim të ardhurat nga pagat vjetore.

### **Kredia e marrë nga personi i lidhur në vitin 2005 dhe verifikimi i ligjshmërisë së burimeve financiare që kanë shërbyer për shlyerjen e saj**

**31.** Ka rezultuar se personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) në datën 28.6.2005 ka lidhur kontratën e kredisë<sup>32</sup>, shërbyer në llogari rrjedhëse në “Alpha Bank”, për kredinë deri në shumën prej 2,500,000 lekësh, me afat 15-vjeçar.

**31.1.** Deri në fund të vitin 2009 (gjatë të cilit subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me znj. B.K, në datën 2.10.2009), detyrimi i mbetur për këtë kredi sipas vetëdeklarimit ka qenë në shumën 1,700,000 lekë<sup>33</sup>.

**31.2.** Konstatohet se në DIP-në e vitit 2010 (depozituar nga personi i lidhur si subjekt deklarues në ILDKPKI), në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ndër të tjera, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar shlyerjen e kësaj kredie, si vijon: (i) shlyerje kësti në datën 7.1.2010, principali në shumën 41,666 lekë dhe interesi në shumën 42,270 lekë; (ii) shlyerja në datën 6.4.2010, shuma 1,200,000 lekë, e marrë hua në datën 2.4.2010; (iii) shlyerje kësti në datën 8.4.2010, principali në shumën 13,950 lekë dhe interesi në shumën 38,902 lekë; si dhe (iv) shlyerje në datën 9.4.2010 e pjesës së mbetur të kredisë në shumën prej 536,903 lekësh, nga të ardhurat vjetore nga paga.

**31.3.** Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të personit të lidhur në “Alpha Bank”<sup>34</sup>, ndër të tjera, konstatohet se në datën 2.4.2010 personi i lidhur, znj. B.K, ka depozituar *cash* në llogarinë e kredisë shumën 1,200,000 lekë dhe në datën 8.4.2010 ka depozituar *cash* po në këtë llogari shumën 536,900 lekë. Në vijim, ka rezultuar se në datën 9.4.2010 është shlyer tërësisht pjesa e kredisë së mbetur, në total shuma e paguar për shlyerjen e kësaj kredie për periudhën 1.1.2010 – 9.4.2010 është 1,878,915 lekë (principal + interesa).

**31.4.** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni<sup>35</sup> se cili ka qenë burimi i të ardhurave të cilat kanë shërbyer për shlyerjen në vitin 2010 të shumës së mbetur të kredisë së marrë nga

<sup>32</sup> Kontratë kredie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.6.2005 (dokumenti ndodhur aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së).

<sup>33</sup> Deklaruar në DPV-në e vitit 2009 nga personi i lidhur si detyrim i mbetur pa shlyer lidhur me këtë kredi.

<sup>34</sup> Shkresa e “Alpha Bank”, protokolluar në Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 3.5.2019.

<sup>35</sup> Pyetësori nr. 2.



personi i lidhur në “Alpha Bank”, ndër të tjera, ka deklaruar se *kredia në “Alpha Bank” është marrë në vitin 2005 nga bashkëshortja kur ai nuk ka qenë i martuar dhe as nuk ka bashkëjetuar me të. Mbylljen e saj bashkëshortja e realizoi duke lidhur një kontratë huaje, pasi nuk mund të përdorte kursimet që ai kishte realizuar në periudhën para martesës. Ata kishin rënë dakord që këto të ardhura do të investoheshin për të blerë një banesë të përbashkët për të jetuar familja e tyre, meqenëse deri në ato momente nuk dispononin asnjë të tillë. Për blerjen e një apartamenti kishin aplikuar për një kredi të butë dhe kushti i përfitimit të kësaj kredie ishte mbyllja e menjëhershme e kredisë së parë bankare të marrë prej bashkëshortes së tij në “Alpha Bank”, pasi nuk mund ta përfitonte në rast të kundërt, pasja e një kredie të mëparshme ishte kusht ndalues.*

**31.5.** Në vijim, subjekti ka shpjeguar se *kontrata e huadhënies me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2010, lidhur midis bashkëshortes së tij dhe shtetases G.N, në shumën 1,200,000 lekë ka pasur si qëllim të vetëm shlyerjen e kredisë së përfutur prej 2,500,000 lekësh, marrë në “Alpha Bank”, deklaruar ky qëllim edhe në deklaratat periodike ndër vite nga bashkëshortja e tij, si dhe në deklaratën “Veting” ku janë paraqitur kontratat respektive.*

**31.6.** Komisioni ka konstatuar se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” (të depozituar nga subjekti) kjo hua është deklaruar vetëm nga personi i lidhur<sup>36</sup>, znj. B.K, dhe konkretisht, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar kontratë huadhënieje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2010, për shumën 1,200,000 lekë. Si qëllim i këtij detyrimi financiar është deklaruar shlyerja e plotë e kredisë së marrë në “Alpha Bank”, në datën 7.7.2005, në shumën 2,500,000 lekë, shlyerja e plotë e së cilës është kryer në datën 9.4.2010. Gjithashtu, konstatohet se sipas deklarimit detyrimi i mbetur i huas së marrë është në vlerën 1,200,000 lekë. Rezulton se kjo hua është deklaruar nga personi i lidhur edhe në DIP-në e vitit 2010.

**31.7.** Ndërsa, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” (shtojca 2), të depozituar nga personi i lidhur në ILDKPKI (në cilësinë e subjektit deklarues), konstatohet se në seksionin e veçantë ka deklaruar se *huadhënësja, znj. G.N, është vajza e tezes dhe se si burim krijimi i shumës së dhënë hua kanë shërbyer të ardhurat e siguruara nga kursimet e saj familjare dhe të bashkëshortit të saj gjatë emigracionit.*

**31.8.** Gjithashtu, Komisioni konstatoi se në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, të datës 6.3.2012, të mbajtur në ILDKPKI<sup>37</sup>, e pyetur lidhur me këtë hua, personi i lidhur, ndër të tjera, ka deklaruar se *shtetases G.N e ka kushëriri dhe se bashkëshorti i saj ka biznes privat dhe disponon të ardhura të mjaftueshme.*

**31.9.** Rezulton se bazuar në kontratën<sup>38</sup> e huadhënies së datës 2.4.2010, huadhënësja G.N i jep huamarrëses B.K shumën prej 1,200,000 lekësh, pa interes, me afat kthimi brenda datës 2.4.2020, dhe se huamarrësja ka deklaruar se në datën 2.4.2010 ka marrë në dorëzim nga huadhënësja shumën prej 1,200,000 lekësh.

**31.10.** Në referim të pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, znj. G.N bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast, bazuar në parimin e proporcionalitetit, të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 1,200,000 lekë, dhënë hua bashkëshortes së subjektit në vitin 2010.

**31.11.** Pasi Komisioni i kërkoi të deklarojë lidhur me këtë marrëdhënie, si dhe mbi burimin e të ardhurave të shtetases G.N, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 1,200,000 lekë,

<sup>36</sup> Deklarimi i bërë veçmas nga personi i lidhur – deklarata e pasurisë e personit të lidhur, bashkëlidhur deklaratës së subjektit.

<sup>37</sup> Përcjellë në Komision me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2019.

<sup>38</sup> Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2010 (kopje e kësaj kontratë ndodhur aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së).

dhënë hua në favor të personit të lidhur, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se huaja në shumën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë është marrë me kontratën e huadhënies nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.4.2010, nga bashkëshortja e tij B.K prej shtetasës G.N, e cila është vajza e tezes së saj. Kjo hua është një detyrim vetjak i bashkëshortes së tij B.K. Në zbatim të nenit 82 të Kodit të Familjes rezulton se detyrimet që bashkëshortët kanë para lidhjes së martesës mbeten detyrime vetjake. Qëllimi i marrjes së kësaj huaje nga bashkëshortja e tij B.K ka qenë shlyerja e një kredie e marrë prej saj përpara lidhjes së martesës, në datën 7.7.2005, nga “Alpha Bank” në vlerën 2,500,000 lekë [...] Duke qenë se huaja në shumën 1,200,000 lekë e marrë nga bashkëshortja e tij nga vajza e tezes së saj ka shërbyer për të shlyer një detyrim vetjak të saj, rezulton se në bazë të nenit 82 të Kodit të Familjes përsëri detyrimi i krijuar në shumën 1,200,000 lekë është një detyrim vetjak që e ka marrë përsipër bashkëshortja kundrejt vajzës së tezes së saj.

**31.12.** Në lidhje me burimin e të ardhurave të shtetasës G.N, subjekti ka deklaruar se i përmbahet të njëjtave shpjegime të dhëna nga bashkëshortja e tij (subjekt rivlerësimi), duke evidentuar se burimi i ligjshëm i kësaj huaje ka qenë një shumë e marrë hua shtetasit A.Gj nga huadhënësja G.N, për hapje biznesi. Subjekti ka depozituar dokumentacion për të dhëna punësimi dhe të dhëna financiare që i përkasin shtetasit A.Gj.

**31.13.** Gjithashtu, në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar dokumentin deklarativ noterial<sup>39</sup>, të bërë nga shtetasja G.N në datën 9.9.2019. Referuar këtij dokumenti, ndër të tjera, kjo shtetase ka deklaruar se shtetasi A.Gj i ka dhënë shumën prej 10,000 euro, të cilën e ka marrë në datën 22.8.2009, për të hapur aktivitetin e saj privat të parukerisë, por se deri më sot nuk ka mundur ta hapë këtë aktivitet. Gjithashtu, bazuar edhe në deklaratën<sup>40</sup> e bërë nga shtetasi A.Gj – depozituar si provë nga subjekti – ky shtetas ka deklaruar se në gusht të vitit 2009 i ka dhënë hua vajzës së tezes së tij, znj. G.N, shumën 10,000 euro, si kredi për të filluar biznesin e parukerisë.

**31.14.** Sa më sipër, duket se subjekti/personi i lidhur ka ndryshuar deklarin gjatë hetimit administrativ lidhur me burimin e krijimit të shumës së dhënë hua nga shtetasja G.N. Për më tepër, nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS duket se shtetasi A.Gj nuk ndodhej në territorin shqiptar në datën 22.8.2009 (dhe as përgjatë gjithë muajit gusht të këtij viti), e deklaruar si datë e marrjes së shumës 10,000 euro nga shtetasja G.N.

**31.15.** Si konkluzion, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, shtetasës G.N, për të evidentuar mundësinë e krijimit të shumës 1,200,000 lekë, të pretenduar si të dhënë hua në favor të bashkëshortes së tij. Pra, duket se personi tjetër i lidhur, znj. G.N, nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të mundësuar dhënien e huas në favor të personit të lidhur, znj. B.K. Theksojmë këtu se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kursimet e tij, likuiditetet e deklaruara si gjendje *cash* deri në fund të vitit 2009, nuk kanë shërbyer si burim për shlyerjen e kredisë së marrë nga personi i lidhur në “Alpha Bank” në vitin 2005.

**31.16.** Sa më sipër, duket se si burim tjetër për shlyerjen e kësaj kredie mund të kenë shërbyer vetëm të ardhurat nga paga të realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për periudhën 1.1.2010 – 9.4.2010 (data e shlyerjes së plotë të pjesës së mbetur të kredisë).

**31.17.** Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe mbi verifikimet e kryera lidhur me huan e pretenduar si të marrë nga shtetasja G.N, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për shlyerjen e kredisë në “Alpha Bank” (kredia e marrë nga personi i lidhur në vitin 2005), nga ku dukej se nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme

<sup>39</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.9.2019.

<sup>40</sup> Deklaratë personale e datës 26 shkurt 2020, (dokument i dorëzuar bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr.3).

për të justifikuar plotësisht shlyerjen deri në datën 9.4.2010, të pjesës së mbetur të kredisë së marrë nga personi i lidhur në “Alpha Bank” në vitin 2005.

**31.18.** Në mbështetje të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet përfundimtare dhe të depozitohë prova të reja të mundshme për ligjshmërinë e burimeve të huadhënësit dhe, si rrjedhojë, për të kundërshtuar rezultatet e analizës financiare lidhur me mundësinë e shlyerjes gjatë vitit 2010 të pjesës së mbetur të kredisë së marrë nga personi i lidhur në vitin 2005 në “Alpha Bank”.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**32.** Subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se kredia e marrë nga bashkëshortja e tij (para martesë) në vitin 2005 në “Alpha Bank” – në kuptim të nenit 82 të Kodit të Familjes – është detyrim vetjak i saj dhe, si rrjedhojë, edhe huaja e marrë prej saj në vitin 2010 nga shtetasja G.N, për shlyerjen e kredisë, është detyrim personal i saj. Në këtë kuptim, subjekti ka kërkuar që në analizën financiare huaja e marrë nga bashkëshortja në vitin 2010 të llogaritet si detyrim vetjak i saj dhe jo si detyrim i shlyer nga bashkësia familjare.

**32.1.** Gjithsesi, subjekti pretendon se huadhënësja G.N ka pasur burime financiare të ligjshme – e konkretisht të ardhurat nga huaja e marrë shtetasit A.Gj – dhe se ndryshimet e bëra në deklaratimet mbi burimin e të ardhurave të huadhënësit nga bashkëshortja kanë ardhur për shkak se ajo nuk ka pasur dijeni për burimin real të këtyre të ardhurave. Subjekti ka deklaruar se bashkëshortja – referuar shkallës së afërme gjinore që kishte me huadhënësen (vajza e tezes së saj) – ka pasur bindjen se familja e bashkëshortit të saj ka pasur një biznes privat “bar - kafe” ku punonte bashkëshorti dhe, për rrjedhojë, ka menduar se ky ka qenë burimi i të ardhurave të saj, krahas faktit që ai ka qenë emigrant ekonomik shumë herë në vende të ndryshme. Pra, sipas subjektit kanë qenë këto dy elementë që kanë bërë që bashkëshortja të besojë se familja e vajzës së tezes së saj i ka siguruar të ardhurat nga këto dy burime.

**32.2.** Në vijim, subjekti ka parashtruar se nga momenti i marrjes së huas dhe deri në momentin që Komisioni gjatë hetimit administrativ i ka kërkuar burimin e krijimit të kësaj huaje, bashkëshortja e tij nuk kanë qenë në dijeni të faktit që shuma prej 1,200,000 lekësh të ketë qenë hua e mëparshme e marrë nga shtetasi A.Gj. Kjo situatë (burimi i krijimit të të ardhurave të shtetasës G.N) është sqaruar pasi bashkëshortja e tij i ka kërkuar të vendosë në dispozicion dokumente për të ardhurat e saj në periudhën që është marrë huaja. Pasi bashkëshortja e tij ka kontaktuar me shtetasen G.N për këtë fakt, ajo i ka treguar se shumë e dhënë hua e dispononte nga djali i tezes A.Gj (njëkohësisht edhe djali i tezes i bashkëshortes së subjektit), i cili ia kishte dhënë si hua për ta ndihmuar në hapjen e një aktiviteti ekonomik, meqenëse ishte e papunë në ato momente. Pasi bashkëshortja u vu në dijeni të këtij fakti, subjekti ka sqaruar se ajo i ka kërkuar shtetasit A.Gj dokumentacion provueshmërie mbi mundësinë e tij për të dhënë një hua të tillë në këtë vlerë.

**32.3.** Në prapësimet e tij, subjekti ka referuar disa dokumente<sup>41</sup>, të evidentuara nga Komisioni të depozituara si pjesë e dokumentacionit provues – bashkëlidhur pyetësorit nr. 3. Konkretisht, ka referuar dy deklaratata noteriale, deklaratën noteriale të shtetasës G.N dhe deklaratën noteriale të shtetasit A.Gj – të pasqyruara si më sipër – si dhe dokumentacion për të ardhura nga punësimi të shtetasit A.Gj.

**32.4.** Gjithashtu, lidhur me konstatimin e bërë nga Komisioni, se shtetasi A.Gj nuk ka qenë në territorin shqiptar në periudhën gjatë të cilës pretendohet të jetë marrë huaja nga shtetasja G.N prej tij, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se fakti që kjo shtetase citon në

<sup>41</sup> Dokumente të cilat nuk e i ka depozituar si provë me dërgimin e prapësimeve.

deklaratën noteriale se e ka marrë në gusht të vitit 2009 shumë prej 10,000 euro nga shtetasi A.Gj, nuk duhet kuptuar se ka një kontratë huaje me shkrim apo një deklaratë noteriale e cila, në qoftë se do ishte nënshkruar nga të dyja palët, do të duhej patjetër të verifikohet prezenca e tyre në kuadër të vlefshmërisë së veprimit juridik. Lidhur me dorëzimin e shumës, ka deklaruar se mund të jetë kryer ose nga shtetasi A.Gj, personalisht ose nga secili prej familjarëve të tij në Shqipëri.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**33.** Pasi analizoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vëren se, referuar nenit 82 të ligjit nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”, detyrimet që bashkëshortët kanë para lidhjes së martesës mbeten detyrime vetjake. Por, nga ana tjetër, në bazë të nenit 81, germa “ç” e këtij Kodi, bashkëshortët përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi për çdo detyrim tjetër kontraktues ose jokontraktues, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara si vjetake në këtë Kod.

**33.1.** Në kushtet kur rezultoi e provuar se personi i lidhur në datën 2.4.2010 ka nënshkruar kontratën e huadhënies me shtetasen G.N (pas lidhjes së martesës), del qartë fakti se ky detyrim është detyrim i përbashkët i bashkësisë familjare. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon si alogjik dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore pretendimin e subjektit se huaja e marrë shtetas G.N përfaqëson detyrim vetjak të bashkëshortes së tij dhe se duhet të trajtohet si e tillë në analizën financiare.

**33.2.** Si rrjedhim, në konsideratë edhe të faktit se subjekti ka pranuar dijeninë për shumën e marrë hua prej bashkëshortes nga shtetasja G.N në vitin 2010, Komisioni konstaton se ai nuk ka përmbushur detyrimin ligjor<sup>42</sup> për deklarimin e kësaj huaje (as në DIP-të vjetore dhe as në deklaratën “Vetting”) dhe detyrimin solidar të mbetur për shlyerjen e saj.

**33.3.** Gjithsesi, Komisioni çmon se në këtë rast rëndësi merr verifikimi i ligjshmërisë së burimeve të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë së marrë nga personi i lidhur në “Alpha Bank” – për sa kohë në momentin e shlyerjes së këtij detyrimi kanë qenë të lidhur në martesë, pavarësisht faktit se kredia ka qenë një detyrim vetjak i bashkëshortes së subjektit.

**33.4.** Në bazë të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016: *“Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”*. Ndërsa, në pikën 13 të nenit 3 të ligjit 84/2016 përcaktohet qartë se bashkëshorti/ja bën pjesë në rrethin e personave të lidhur me subjektin për periudhën e rivlerësimit.

**33.5.** Në këtë këndvështrim, si dhe bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk mund t’i shmanget kontrollit dhe përgjegjësisë për verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë së personit të lidhur, në një kohë që ai ka qenë i lidhur në martesë me të. Nga ana tjetër, Komisioni vlerëson se nuk janë bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti mbi ndryshimet e bëra në deklarimin e burimit të të ardhurave të huadhënës G.N.

**33.6.** Në pikën 4 të nenit 32 të ligjit 84/2016, parashikohet se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose personat e tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë”*.

**33.7.** Siç u evidentua më sipër, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” (shtojca 2), të depozituar nga personi i lidhur në ILDKPKI (në cilësinë e subjektit deklarues), ndër të tjera, konstatohet se në seksionin e veçantë ka deklaruar: *“Huadhënësja G.N është vajza e tezes dhe*

<sup>42</sup> Në përputhje me ligjin për deklarimin e pasurive dhe ligjin e rivlerësimit kalimtar.

*se si burim krijimi i shumës së dhënë hua kanë shërbyer të ardhurat e siguruara nga kursimet e saj familjare dhe të bashkëshortit të saj gjatë emigracionit”.*

**33.8.** Duke qenë se deklarata e rivlerësimit kalimtar “Vetting” është një deklaratë specifike e plotësuar kryesisht bazuar dhe në përputhje me parashikimet e bëra në ligjin nr. 84/2016, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur kanë pasur detyrimin ligjor që krahas deklaramit të detyrimeve financiare, në rastin e huas së marrë nga shtetasja G.N, të deklaronin dhe të provonin me dokumentacion justifikues ligjor edhe burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës së dhënë hua prej saj.

**33.9.** Komisioni vëren se në deklaratën “Vetting” personi i lidhur ka përmbushur një pjesë të detyrimit ligjor – duke deklaruar burimin e krijimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, por se nuk ka depozituar dokumentacion provues mbi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

**33.10.** Në këtë kuptim, duket se në kushtet kur subjekti dhe/apo personi i lidhur janë gjendur para faktit të mungesës së dokumentacionit mbi të ardhura të ligjshme të krijuara nga huadhënësja G.N, kanë ndryshuar deklaramin mbi burimin e të ardhurave të saj, në përpjekje për të justifikuar ligjshmërinë e tyre.

**33.11.** Për më tepër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë deklaramet e dhëna prej tij apo personit të lidhur gjatë hetimit administrativ, e konkretisht nuk dokumentoi ekzistencën e aktivitetit “bar-kafe” të familjarëve të huadhënësës, si dhe faktin e emigrimit të bashkëshortit të huadhënësës në periudha të ndryshme kohore. Gjithashtu, vërehet se edhe përpjekja për të ndryshuar burimin e të ardhurave të huadhënësit shoqërohet me deklarime të paplota dhe situata të paqartësuar, pasi në kushtet kur subjektit i ka kaluar barra e provës për të shpjeguar dhe provuar gjithë marrëdhënien e pretenduar të huadhënies dhe ligjshmërinë e burimeve të huadhënësit, në vlerësimin e trupi gjykues nuk duken bindëse deklarime të tilla si *shtetasi A.Gj mund ta ketë sjellë vetë ose nëpërmjet familjarëve shumën 10,000 euro në Shqipëri.*

**33.12.** Në vijim të arsyetimit duket se nuk përbën logjikë ekonomike fakti që në të njëjtën kohë subjekti, sipas vetëdeklarimit, dispononte të ardhura të konsiderueshme në formë kursimesh në gjendje *cash* (shumën 2,500,000 lekë) dhe nga ana tjetër bashkëshortja e tij të merrte hua shumën 1,200,000 lekë.

**33.13.** Në dritën e këtyre fakteve, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme se kemi të bëjmë me një marrëdhënie fiktive huamarrjeje, me qëllim justifikimin e ligjshmërisë së burimeve të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e kredisë së personit të lidhur në “Alpha Bank”, kjo e lidhur me veprimet e mëposhme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, të cilët duket se kanë pasur synim blerjen e një apartamenti në Tiranë, pasurisë objekt vlerësimi.

**33.14.** Si përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe, si rrjedhojë, gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm lidhur me marrëdhënien e huadhënies me shtetasen G.N, sipas parashikimit të bërë në nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur.

**33.15.** Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe pas arsyetimit të kryer në vlerësimin e marrëdhënies së huadhënies me shtetasen G.N, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë<sup>43</sup> me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit

---

<sup>43</sup> Pretendimet e tjera të subjektit lidhur me analizën financiare për periudhën 1.1.2010 – 9.4.2010 janë kryesisht të karakterit deklarativ dhe me efekt të papërfillshëm dhe, si të tilla, nuk janë reflektuar në analizën financiare përfundimtare.

dhe personit të lidhur, për shlyerjen e kredisë në Alpha Bank (kredia e marrë nga personi i lidhur në vitin 2005), të pasqyruar në tabelën si vijon:

**Tabela nr. 4.**

Analiza financiare për periudhën 1.1.2010 – 9.4.2010	Vlerat në lekë
<b>PASURI</b>	<b>25,103</b>
Ndryshim likuiditeti	25,103
Total likuiditete	2,612,011
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
Hua nga G.N	0
<b>PASURI NETO</b>	<b>25,103</b>
<b>Të ARDHURA</b>	<b>520,560</b>
Të ardhura nga paga ushtrimi i detyrës, subjekti	290,496
Të ardhura nga paga, bashkëshortja e subjektit	179,380
Të ardhura nga ISSH (leje barrë lindjeje), bashkëshortja e subjektit	50,684
<b>SHPENZIME</b>	<b>2,050,301</b>
Shpenzime jetike	108,922
Shpenzime për pagesë dhe shlyerje këstesh dhe mbyllje të parakohshme kredie “Alpha Bank”	1,878,915
Shpenzime udhëtimi	62,465
<b>BALANCA E FONDEVE</b>	<b>-1,554,845</b>

**33.16.** Sa më sipër, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar saktë dhe me vërtetësi dhe se nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shlyerjen deri në datën 9.4.2010 të pjesës së mbetur të kredisë së marrë nga personi i lidhur në “Alpha Bank” në vitin 2005, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në geramat “a” dhe “b” të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**33.17.** Në vijim, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar në total shumën 1,000,000 lekë si shtesë pasurie gjendje *cash* gjatë vitit 2010, me qëllim evidentimin e mundësisë së krijimit të kësaj pasurie – bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ – Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për vitin 2010, të pasqyruar në tabelën si vijon:

**Tabela nr. 5.**

Analiza financiare për vitin 2010	Vlerat në lekë
<b>PASURI</b>	<b>957 237</b>
Ndryshim likuiditeti	957 237
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>
Hua nga G.N	0
<b>PASURI NETO</b>	<b>957 237</b>
<b>Të ARDHURA</b>	<b>1 775 119</b>
Të ardhura nga paga ushtrimi i detyrës, subjekti	900 895
Të ardhura nga paga, bashkëshortja e subjektit	796 000
Të ardhura nga ISSH (leje barrë lindjeje) bashkëshortja e subjektit	50 684
Të ardhura ZABGJ, bashkëshortja e subjektit	27 540
<b>SHPENZIME</b>	<b>2 483 901</b>

Shpenzime jetike	409 860
Shpenzime për pagesë kredie në “Alpha Bank”	1 878 915
Shpenzime për celularin, personi i lidhur B. K.	37 561
Shpenzime udhëtimi	62 465
Shpenzime arredimi	95 100
<b>BALANCA E FONDEVE</b>	<b>-1 666 018</b>

**33.18.** Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara nga Komisioni, përgjatë vitit 2010.

**33.19.** Pasi iu kalua barra e provës, me prapësimet e dërguara, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar rezultatet e analizës financiare, duke pretenduar që shlyerja e kredisë së marrë nga bashkëshortja e tij në “Alpha Bank” të përlllogaritet si detyrim vetjak i shlyer me fondet e siguruar prej huas së marrë nga shtetasja G.N dhe të ardhurat e tjera të saj dhe, si rrjedhojë, në kushtet e përfshirjes në analizë financiare edhe të fondeve të përfituara nga huaja e marrë në vitin 2010, ai dhe personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* në fund të vitit 2010 (deklaruar në DIP-në e vitit 2010).

**33.20.** Si konkluzion, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në analizën e kryer si më sipër lidhur me marrëdhënien e huadhënies mes personit të lidhur dhe shtetas G.N, trupi gjykues i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar për analizën financiare që i përket vitit 2010, të pasqyruar në tabelën si më sipër (tabela nr. 5) dhe, si rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

**33.21.** Në analizën e ecurisë së likuiditeteve *cash* ndër vite duket se, bazuar në vetëdeklarimet e bëra deri në fund të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit pretendon se dispononte pasurinë e llojit “likuiditete *cash*” në vlerën 2,500,000 lekë.

**33.22.** Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni rezultoi se vitet 2003 - 2009, gjatë të cilave është deklaruar krijimi i kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, paraqiten me balancë negative fondesh, në total në shumën prej 1,007,802 lekësh. Në këtë kuptim, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e këtyre vlerave monetare ndër vite – pasi janë evidentuar balanca negative në analizën financiare të kryer për vitet 2006 dhe 2008.

**33.23.** Nga ana tjetër, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të mundësuar plotësisht krijimin e kursimeve në formë likuiditetesh *cash* në shumën prej 1,000,000 lekësh, të deklaruara prej tyre në DIP-në e vitit 2010.

**33.24.** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur pretendojnë se deri në fund të vitit 2010 kanë disponuar kursimet në formë likuiditetesh *cash* në shumën prej 3,500,000 lekësh. Por, sikurse u evidentua më sipër, subjekti nuk ka deklaruar krijimin e dy depozitave bankare, pakësimin e tyre dhe as destinacion pas pakësimit (tërhequr plotësisht fondet nga depozitat bankare në shumën 12,000 USD – përgjatë vitit 2009).

**33.25.** Në vijim të vlerësimit të provave, referuar procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”<sup>44</sup>, datë 6.3.2012: (i) i pyetur<sup>45</sup> lidhur me depozitën 10,000 USD, të hapur në “Emporiki Bank” në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera ka deklaruar se [...] *këtë vlerë e ka gjendje cash në banesë [...]*; dhe (ii) i pyetur në lidhje me depozitën e hapur në

<sup>44</sup> Dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2019, të ILDKPKI-së.

<sup>45</sup> Pyetja nr. 6.

“Raiffeisen Bank” në vitin 2008, me gjendje fillestare në shumën 10,000 USD, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se [...] *aktualisht e ka gjendje cash në banesë* [...].

**33.26.** Komisioni vlerëson se këto deklarime të paqarta dhe kontradiktore të bëra ndër vite nga subjekti i rivlerësimit lidhur me ecurinë e likuiditeteve *cash* dhe në bankë e bëjnë të ndodhet në kushtet e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe janë të tilla që e vendosin në vështirësi këtë trup gjykues për të analizuar saktë burimet financiare për mundësinë e kryerjes së pagesës prej 1,250,000 lekësh deri në datën 20.6.2011, në favor të investitorit J.T, për porositjen e apartamentit në Berat.

**33.27.** Në këto rrethana, në kushtet kur porositja e apartamenteve në Berat dhe në Tiranë, si dhe pagesat për likuidimin e çmimit për to janë kryer përgjatë të njëjtit vit (vitit 2011), Komisioni u përqendrua duke u thelluar në analizimin e ligjshmërisë së burimeve të pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

**33.28.** Sa i përket depozitave bankare, Komisioni konstaton se ka mospërputhje në lidhje me deklarimin e përdorimit të vlerave të tyre, përkatësisht të krijuara gjatë viteve 2006 dhe 2008, në total në shumën 20,000 USD, pasi:

**a.** Në DIP-të e viteve 2006 dhe 2008 subjekti nuk i deklaroi këto depozita, por në shpjegimet e dhëna Komisionit gjatë hetimit administrativ, deklaroi se këto depozita janë me burime nga gjendja *cash* e deklaruar gjatë viteve (gjendje e cila ka shërbyer si burim për pagesën e kështit të apartamentit objekt vlerësimi në vitin 2011).

**b.** Ndërkohë, në procesverbalin e datës 6.3.2012, mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti deklaroi se shumën e këtyre dy depozitave prej 20,000 USD e ka gjendje *cash* në banesë.

**38.29.** Në këto kushte, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi. Pasi Komisioni i kaloi barrën e provës, subjekti parashitri se, duke parë në tërësi deklaratimet e tij dhe deklaratimet e bëra në vitin 2012 në ILDKPKI, ka shpjeguar se pas tërheqjes janë mbajtur *cash* në banesë këto vlera monetare dhe se nuk i ka disponuar *cash* në momentin e firmosjes së procesverbalit. Në vijim, ka deklaruar se nuk i dispononte këto vlera *cash* në vitin 2012, pasi i ka deklaruar se i ka shpenzuar për blerjen e apartamentit në vitin 2011.

**33.30.** Komisioni vëren se, krahas faktit të mosdeklarimit të këtyre depozitave, pas tërheqjes së tyre në vitin 2009, ato nuk janë deklaruar si burim krijimi i pasurisë së llojit “likuiditete *cash*”. Rezulton se si burim krijimi i likuiditeteve *cash* të deklaruara në DIP-të e viteve 2009 dhe 2010 janë deklaruar të ardhurat vjetore nga pagat. Në këtë kuptim, shpjegimet e dhëna nga subjekti me dërgimin e prapësimeve nuk përputhen me deklaratimet e bëra prej tij ndër vite në ILDKPKI.

**33.31.** Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se vlera ekuivalente në lekë e shumës 20,000 USD, pretenduar si pjesë e shumës së kursyer *cash* deri në fund të vitit 2010, nuk ka shërbyer si burim për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi gjatë vitit 2011, pasi subjekti ka deklaruar se e ka disponuar *cash* këtë shumë në vitin 2012.

**33.32.** Siç u evidentua më sipër, me deklaratën noteriale<sup>46</sup> të datës 16.9.2011 u revokua kontrata e porosisë e lidhur mes bashkëshortes së subjektit dhe shtetasit J.T për apartamentin me sip. 114.5 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Berat. Referuar këtij akti, palët deklarojnë se me pëlqimin dhe vullnetin tyre të lirë kanë zgjidhur kontratën nr. \*\*\*, datë 27.5.2011, duke bërë edhe likuidimet e duhura për këtë rast.

**33.33.** Në deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se po në të njëjtën datë (16.9.2011) bashkëshortes së tij i është kthyer nga shtetasi J.T shuma prej 6,150,000 lekësh, konfirmuar me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 16.9.2011. Në kushtet kur rezultoi e provuar se

<sup>46</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.9.2011.



deri në datën 22.7.2011 personi i lidhur ka kryer pagesa në favor të shtetasit J.T (në cilësinë e investitorit të objektit) nëpërmjet sistemit bankar shumë prej 6,150,000 lekësh, si rrjedhojë, duket se në datën 16.9.2011, me nënshkrimin e deklaratës noteriale për revokimin e kontratës së porosisë, personi i lidhur ka marrë shumë prej 6,150,000 lekësh.

**33.34.** Në datën 1.10.2011 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë lidhur me shoqërinë “Sh” sh.p.k. kontratën e sipërmarrjes<sup>47</sup>, me objekt porositjen e një apartamenti banimi me sip. 90.12 m<sup>2</sup> në objektin që ka ndërtuar kjo shoqëri në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, për çmimin 8,200,000 lekë.

**33.35.** Në këtë kontratë është përcaktuar plani i pagesave, si vijon: (i) me firmosjen e kësaj kontrate porositësit paguajnë shumë 5,000,000 lekë; dhe (ii) mbetjen prej 3,200,000 lekësh porositësit do ta paguajnë në dy këste: kësti i parë do të paguhet në fund të tetorit; dhe kësti i dytë do të paguhet në fund të nëntorit.

**33.36.** Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në DIP-në e vitit 2011, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, si dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni, duket se si burim krijimi i kësaj pasurie kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga revokimi i kontratës së sipërmarrjes për apartamentin e porositur në Berat (ku përfshihen të ardhurat e përfituara nga kredia në BKT) dhe kursimet e tij personale e familjare ndër vite.

**33.37.** Konstatohet se gjatë vitit 2011 është shlyer tërësisht çmimi prej 8,200,000 lekësh, i paguar *cash* në favor të shoqërisë ndërtuese me këste, si vijon: (i) në datën 1.10.2011 paguar shuma 5,000,000 lekë<sup>48</sup>; (ii) në datën 25.10.2011 paguar shuma 2,000,000 lekë<sup>49</sup>; dhe (iii) në datën 28.11.2011 paguar shuma 1,200,000 lekë<sup>50</sup>. Gjithashtu, rezulton se në deklaratën e datës 28.11.2011 (shkresë e thjeshtë), nënshkruar midis bashkëshortes së subjektit B.K dhe ortakut të vetëm të shoqërisë “Sh” sh.p.k., shtetasit F.Sh, përcaktohet se pala porositëse ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj palës sipërmarrëse.

**33.38.** Nisur nga deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në konsideratë të faktit se çmimi për porositjen e apartamentit në Berat është paguar dhe kthyer brenda vitit, për efekt analize duket se si burim për blerjen e pasurisë objekt vlerësimit, apartamentit në Tiranë, ka shërbyer kredia lehtësuese e marrë në BKT dhe kursimet personale dhe familjare të subjektit të rivlerësimit ndër vite.

**33.39.** Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të dërguar nga BKT-ja duket se, pas miratimit dhe disbursimit të kredisë, nga shuma prej 5,000,000 lekësh, vetëm shuma 4,900,000 lekë është përdorur për likuidimin e çmimit për apartamentin e prenotuar në Berat, e cila do të konsiderohet e kthyer në referim të deklaratës noteriale të datës 16.9.2011, për revokimin e kontratës së porosisë.

**33.40.** Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë disponuar burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e këstit të parë, të kryer në datën 1.10.2011 në favor të shoqërisë “Sh” sh.p.k., në shumë 5,000,000 lekë, për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi, e konkretisht, fondet e përfituara nga kredia bankare, duke shtuar edhe vlerën prej 100,000 lekësh nga kursimet e deklaruara ndër vite, apo qoftë edhe nga të ardhurat e vitit 2011.

---

<sup>47</sup> Kontratë sipërmarrje datë 1.10.2011, e konfirmuar me dokumentin noterial vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.10.2011.

<sup>48</sup> Depozituar mandatpagesa e datës 1.10.2011, shuma 5,000,000 lekë - me përshkrimin “Blerje apartamenti nr. \*\*\*, kati \*\*\* teknik, rr. ‘\*\*\*’, Tiranë”.

<sup>49</sup> Depozituar mandatpagesa e datës 25.10.2011, shuma 2,000,000 lekë - me përshkrimin “Blerje apartamenti nr. \*\*\*, kati \*\*\* teknik, rr. ‘\*\*\*’, Tiranë”.

<sup>50</sup> Depozituar mandatpagesa e datës 28.11.2011, shuma 1,200,000 lekë - me përshkrimin “Blerje apartamenti nr. \*\*\*, kati \*\*\* teknik, rr. ‘\*\*\*’, Tiranë”.

**33.41.** Ndërsa, siç u evidentua më sipër – bazuar në vetëdeklarimet e subjektit – duket se në fund të vitit 2010 ai dhe bashkëshortja dispononin në total shumë prej 3,500,000 lekësh si pasuri në formë likuiditetesh *cash* të krijuara përgjatë viteve 2003 - 2010, të cilat deklarohen si burim krijimi për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

**33.42.** Por, nga ana tjetër, nga analiza financiare e kryer nga njësia e shërbimit ligjor për vitet 2003 -2010, rezulton se vitet 2006, 2008 dhe 2010 paraqiten me balancë negative fondesh dhe, si rrjedhojë, trupi gjykues çmon se verifikimi i mundësisë për kryerjen e pagesës së këstit të dytë dhe të tretë përgjatë vitit 2011, për blerjen e apartamentit në Tiranë, varet detyrimisht nga rezultati i kësaj analize, duke vlerësuar se kjo mungesë burimesh logjikisht reflekton edhe në mundësinë e krijimit të kursimeve të deklaruara si të përdorura për pagimin e këtyre kësteve, në total në shumë prej 3.200,000 lekësh.

**33.44.** Gjithashtu, nga hetimi i kryer Komisioni konstatoi se në procesverbalin e datës 6.3.2012, mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se disponon gjendje *cash* në shumë prej 20,000 USD, me burim mbylljen e depozitave.

**33.45.** Në këtë kuptim, në analizë logjike, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi për të disponuar gjendje likuiditetesh *cash* nga burime financiare të ligjshme për të mundësuar pagesën e këstit të dytë dhe të tretë gjatë vitit 2011, për apartamentin në Tiranë.

**33.46.** Si konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit në Tiranë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

### **Trajtimi i kredisë së marrë nga personi i lidhur në vitin 2011 në BKT**

**34.** Rezulton se në datën 19.7.2011 bashkëshortja e subjektit B.K ka lidhur kontratën<sup>51</sup> e kredisë bankare me BKT-në, nëpërmjet së cilës kjo e fundit ka akorduar në favor të kredimarrësit (personit të lidhur) një total kreditimi prej 5,000,000 lekësh. Në këtë kontratë kredie subjekti i rivlerësimit shfaqet në cilësinë e dorëzanësit. Gjithashtu, në cilësinë e dorëzanësve në këtë kredi janë edhe prindërit e personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit) dhe si kolateral<sup>52</sup> për marrjen e kësaj kredie janë vendosur pasuri të regjistruara në emër të babait të saj.

**34.1.** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ lidhur me këtë kredi ka rezultuar se personi i lidhur ka përfituar kredinë në shumë 5,000,000 lekë me kushte lehtësuese, bazuar në VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”.

**34.2.** Me VKM-në nr. 1714, datë 29.12.2008, “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 600, datë 12.9.2007, të Këshillit të Ministrave, ‘Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë’”, në rrethin e personave subjekteve përfitues janë shtuar edhe gjykatësit e gjykatave të apelit dhe të rretheve gjyqësore.

**34.3.** Si rrjedhim, Komisioni konstaton se në vitin 2011 personi i lidhur, për shkak të detyrës, bënte pjesë në rrethin e personave/subjekteve të cilëve u lindte e drejta për të përfituar kredi lehtësuese, sipas parashikimeve të bëra në VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007.

**34.4.** Në pikën 2 të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, përcaktohet se të gjitha subjekteve të parashikuara në këtë vendim, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës apo të funksionit shtetëror, kur kanë nevojë për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, u lind e drejta të kërkojnë trajtim me kredi në kushte lehtësuese nga shteti, për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi në vendin e

<sup>51</sup> Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.7.2011.

<sup>52</sup> Kontratë hipotekimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.7.2011, me BKT-në.

ushtrimit të detyrës, që sipas këtij vendimi nënkupton territorin e rrethit ku ndodhet selia administrative e organit ku subjekti kryen funksionin a ushtron detyrën.

**34.5.** Nga të dhënat e administruara rezulton se personi i lidhur, në momentin e aplikimit për kredi, e deri në datën 16.7.2013, ka qenë me funksion gjyqtare dhe së fundmi kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Gjithashtu, në pikën 6 të VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, krahas kritereve të tjera ndaluese është parashikuar se u lind e drejta për të përfituar kredi lehtësuese subjekteve të cilët në vendin e ushtrimit të detyrës nuk kanë në pronësi të tyre, bashkëshortit/es apo çdo pasardhësi, paraardhësi a personi tjetër në ngarkim, pasuri të luajtshme për strehim, me sipërfaqe banimi sipas kuotave të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi, kusht i cili (si detyrim parësor) duket se përmbushet nga personi i lidhur në momentin e aplikimit për marrjen e kësaj kredie.

**34.6.** Akti nënligjor ka përcaktuar se aplikuesi duhet të paraqesë kërkesën me shkrim pranë titullarit të institucionit ku ushtron detyrën, të shoqëruar me: (a) certifikatën e përbërjes familjare në çastin e dorëzimit të kërkesës; (b) deklaratën për rrethanat që mbështesin nevojën për strehim dhe për çdo deklaram, për të përfituar nga kredia lehtësuese subjekti konfirmon vërtetësinë e tyre dhe pranon kushtin për konvertimin e drejtpërdrejtë të kredisë lehtësuese në kredi tregtare, kur vërtetohen pavërtetësi në deklaram dhe/ose rrethana të rreme. Në këto raste, VKM-ja ka parashikuar si penalitet se, kur gjatë apo pas zbatimit të kredisë rezultojnë se në kërkesë janë bërë deklaram të rreme, kredia konvertohet drejtpërdrejt në kredi tregtare, kusht i përcaktuar edhe në kontratën e kredisë, dhe se në këtë rast institucioni bankar është i detyruar që diferencat e dhëna nga buxheti i shtetit për kreditë, të cilat konvertohen në kredi tregtare, t'ia kthejë përsëri buxhetit.

**34.7.** Në përmbushje të destinacionit/qëllimit të marrjes së kredisë, me kontratën e porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.5.2011, personi i lidhur ka porositur apartament me sip. 114.5 m<sup>2</sup>, në vlerën 6,000,000 lekë, me adresë: lagjia “\*\*\*\*”, Berat (kontratë/pasuri e trajtuar si më sipër).

**34.8.** Në vijim, konstatohet se megjithëse personi i lidhur ka vazhduar të ushtrojë detyrën në qytetin e Beratit, ka revokuar kontratën e porosisë dhe shumën e kthyer (ku bën pjesë dhe vlera e përfituar nga kredia me kushte lehtësuese) është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të ndodhur në Tiranë, me sip. 90.12 m<sup>2</sup>, porositur nga shoqëria “Sh” sh.p.k., në vitin 2011.

**34.9.** Sa më sipër, duket se është ndryshuar destinacioni dhe qëllimi i kredisë së përfituar me kushte lehtësuese, në kundërshtim me kriteret dhe detyrimet ligjore të zbatueshme në përfitimin e këtyre kredive dhe se vlera e përfituar nga kjo kredi është deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**35.** Pasi Komisioni i kërkoi shpjegime për konstatimin e bërë lidhur me kredinë me kushte lehtësuese të përfituar nga personi i lidhur në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se bashkëshortja e tij, B.K, me cilësinë e subjektit të rivlerësimit, ka dhënë shpjegime para Komisionit për këtë problematikë, pasi marrja e kredisë është kryer vetëm prej saj dhe jo prej subjektit. Ashtu sikundër Komisioni në shumë raste të tjera të bashkëshortëve si subjekte të rivlerësimit i ka hetuar dhe i ka ndarë problematikat e veçanta për secilin prej tyre, kërkon që edhe për të të mbahet i njëjti standard dhe mos të përfshihen në hetimin e tij administrativ problematika që i përkasin hetimit administrativ të bashkëshortes. Po kështu, ka pretenduar se kredia nga BKT-ja është marrë nga bashkëshortja e tij për shkak të funksionit si gjyqtare dhe nuk mund të sjellë pasojë mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

**35.1.** Në vijim, subjekti ka deklaruar se për të shmangur çdo keqinterpretim nga Komisioni për mosbashkëpunim, bën prezent argumentet e tij për këtë problematikë, nga verifikimi i të cilave duket se në mënyrë të përmbledhur shpjegon se:

**a.** Bashkëshortja e tij, për shkak të funksionit dhe për shkak se nuk dispononte pasuri në vendin e ushtrimit të detyrës, përmbushte kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 600, për përfitimin e kësaj kredie.

**b.** Në përmbushje të destinacionit/qëllimit të marrjes së kredisë, me kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 27.5.2011, ka porositur apartament me sip. 114.5, në vlerën 6,000,000 lekë, me adresë: lagjja “\*\*\*”, Berat. Sipas *statement*-it të BKT-së kredia është disbursuar në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në datën 21.8.2011, në vlerën 4.950.000 lekë dhe në datën 22.8.2011 shuma prej 4,900,000 lekësh i ka kaluar shtetasit J.L.T për blerje apartamenti. Më tej është revokuar kontrata e porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.5.2011, sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.9.2011 (rreth 4 muaj pas nënshkrimit të kontratës së porosisë). Të gjitha këto veprime të kryera nuk janë fiktive, por se për arsye të rrethanave të reja që po krijoheshin në familje është diktuar kjo zgjidhje, duke u porositur apartamenti në Tiranë, një pjesë e çmimit të të cilit është paguar nga fondet e kthyer nga revokimi i kontratës së Beratit, ku bënë pjesë edhe fondet e përfituara nga kredia lehtësuese.

**35.2.** Subjekti ka bërë një analizë të gjerë të kushteve të përfutimit të kësaj kredie dhe të qëllimit të dhënies së tyre, ku në thelb referon faktin se ajo është marrë në përmbushje të të gjitha kushteve dhe kriterëve ligjore dhe se qëllimi final, destinacioni i saj, ka qenë strehimi, në këtë rast blerja e apartamentit në Tiranë. Pra, subjekti pretendon se kredia është marrë në përmbushje të plotë të kriterëve ligjore dhe se është përdorur për qëllimin për të cilin ajo është dhënë.

### **Vlerësimi përfundimtar i Komisionit**

**36.** Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e dhëna, Komisioni gjen me vend që së pari të arsyetojë lidhur me detyrimet që e lidhin subjektin e rivlerësimit me këtë kredi dhe përfitimet prej saj.

**36.1.** Bazuar në nenin 66 të Kodit të Familjes, regjimi pasuror martesor i bashkëshortëve rregullohet me ligj, në mungesë të marrëveshjes së veçantë, ku bashkëshortët parashikojnë regjimin që dëshirojnë, i cili nuk duhet të vijë në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës. Ndërsa, sipas nenit 73 të këtij Kodi, *regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor.*

**36.2.** Neni 74 i Kodit të Familjes, ndër të tjera, përcakton se bashkësia përbëhet nga: “[...] (a) pasuria e fituar nga të dy bashkëshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës [...]”. Gjithashtu, në referim të nenit 81 të këtij Kodi, *bashkëshortët përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi për çdo detyrim kontraktues.* Sa më sipër, në kushtet kur nuk rezultoi e provuar që subjekti të ketë lidhur kontratë martesore sipas parashikimeve të bëra në nenin 69 të Kodit të familjes, *ai do të konsiderohet si i martuar nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore.*

**36.3.** Pra, është fakt i pakundërshtueshëm se kredia e marrë në BKT në vitin 2011 është detyrim i përbashkët i dy bashkëshortëve dhe në këtë kuadër Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin ligjor, duke e deklaruar si detyrim financiar, qoftë në DIP-të vjetore, po ashtu edhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

**36.4.** Si rrjedhim, Komisioni vëren se subjekti ka qenë i vetëdijshëm se detyrimi financiar që rridhte nga kjo kredi është detyrim i bashkësisë familjare dhe se do të përgjigjej solidarisht për shlyerjen e tij, pavarësisht se në kontratën e kredisë shfaqet si dorëzanës. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit është përfitues direkt i kredisë dhe i kushteve lehtësuese të saj, për sa kohë shuma e marrë ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi – apartamentit në Tiranë –

i cili në kuptim të ligjit është pasuri që i përket bashkësisë familjare, pra pasuri e përbashkët e tij dhe e personit të lidhur.

**36.5.** Në këtë këndvështrim, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e bashkëkredimarrësit faktik, krahas detyrimit për t'u përgjigjur solidarisht në shlyerjen e kësaj kredie, nuk mund të shmanget nga kërkesa për llogaridhënie lidhur me zbatimin e kushteve të tjera të kontratës së kredisë, për sa kohë është përfitues i drejtpërdrejtë prej saj dhe se për më tepër në këtë rast kemi të bëjmë me një kredi me kushte lehtësuese, e cila në rastin e mospërbushjes së kushteve do të kthehej në kredi me kushte tregu.

**36.6.** Në vijim të vlerësimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmon se ai nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit dhe, si rrjedhojë, i qëndron konstatimit dhe rezultatit fillestar se veprimet juridike të kryera në funksion të përfitimit të kësaj kredie me kushte lehtësuese për të financuar blerjen e një banese tjetër në Tiranë janë kryer në tejkalim të parashikimeve ligjore mbi përfitimin e saj.

**36.7.** Këto veprime vlerësohen se janë kryer me dijeninë e plotë të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, dhe rezulton se ai nuk ka bërë asnjë përpjekje për deklarimin e faktit të revokimit të kontratës së sipërmarrjes për apartamentin në Berat dhe përdorimin e fondeve të kredisë për blerjen e një apartamenti në Tiranë, duke përfituar në mënyrë të kundërligjshme nga ky mosdeklarim me vërtetësi i rrethanave të reja – e konkretisht ka shmangur konvertimin e saj në kredi me kushte tregu dhe kthimin e shumave të dhëna nga buxheti i shtetit për këtë kredi.

**36.8.** Për më tepër, subjekti ka deklaruar se kontrata e sipërmarrjes për apartamentin në Tiranë ka qenë bërë draft që në korrik të vitit 2011, ndërkohë që nga verifikimi i dokumentacionit bankar rezulton se kredia është disbursuar në datën 21.7.2011 në llogarinë e personit të lidhur në BKT, dhe se në datë 22.7.2011 është transferuar shuma prej 4,900,000 lekësh në favor të shtetasit J.T, për blerjen e apartamentit në Berat.

**36.9.** Në dritën e këtyre fakteve, duket se qëllimi i subjekti të rivlerësimit dhe personit të lidhur ka qenë blerja e një apartamenti në Tiranë, por se për të mundësuar përfitimin dhe disbursimin e kredisë me kushte lehtësuese kanë lidhur kontratë sipërmarrjeje për blerje apartamenti në Berat, duke kaluar shumën e përfituar në favor të investitorit/palës shitëse, shtetasit J.T, me qëllim përmbushjen në dukje të kushteve të parashikuara për përfitimin e saj.

**36.10.** Në vlerësim dhe analizim të provave të administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni evidentoi faktin se kontrata për furnizimin me energji elektrike për apartamentin në Tiranë është lidhur në emër të bashkëshortes së subjektit para nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes për këtë pasuri, e konkretisht në datën 2.8.2011. Në këtë kuptim, Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur ka pasur një kontratë të fshehtë me shoqërinë “Sh” sh.p.k. dhe/apo se mund të kenë kryer pagesa gjatë muajit korrik në funksion të blerjes së apartamentit në Tiranë.

**36.11.** Vërehet se kontrata e sipërmarrjes për prenotimin e apartamentit në Berat është revokuar në datën 16.9.2011, por nga ana tjetër subjekti dhe personi i lidhur kishin bërë një draft kontrate me shoqërinë “Sh” sh.p.k., që në korrik të vitit 2011 dhe se kontrata e energjisë elektrike për këtë apartament është lidhur në datën 2.8.2011.

**36.12.** Në këtë kontekst, duke mbajtur në konsideratë edhe fondet e disponueshme në dispozicion për atë periudhë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur garanci të plotë se fondet e përfituara nga kredia në BKT dhe fondet e tjera të kaluara në referim të kontratës së sipërmarrjes për apartamentin në Berat do i ktheheshin mbrapsht dhe do ishin të disponueshme për t'u përdorur prej tyre për blerjen e apartamentit në Tiranë.

**36.13.** Të gjitha këto argumente, duke u ndërthurur edhe me transaksionet e kryera në *cash* për blerjen e apartamentit në Tiranë, krijojnë bindjen se kontrata e porosisë e datës 27.5.2011, për blerjen e apartamentit me sip. 114.5 m<sup>2</sup> në qytetin e Beratit është fiktive dhe e bërë me qëllim përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese nga shteti në shumën 5,000,000 lekë.

**36.14.** Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se personi i lidhur ka kryer një sërë veprimesh fiktive në dijeni të plotë të subjektit të rivlerësimit, me qëllim përfitimin e kredisë lehtësuese dhe përdorimin e saj jashtë destinacionit dhe qëllimit për të cilën ishte përfituar, në tejkalim të parashikimeve ligjore.

## **Çështje të tjera të hetuara nga Komisioni**

### **Në lidhje me deklarinimin e adresave të banimit**

#### *1) Periudha 2003 – 2004*

**37.** Në DPV-të e viteve 2003 dhe 2004 subjekti ka deklaruar si adresë banimi apartamentin me sip. 123 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugën “\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, Tiranë.

**37.1.** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, për pronësinë e saj apo marrëdhënien mbi bazën e së cilës e ka përdorur këtë apartament, si dhe mbi shpenzime të tjera të mundshme të kryera prej tij në këtë apartament, ndër të tjera, ka deklaruar se<sup>53</sup> në deklaratën fillestare të pasurisë dhe në DPV-në e vitit 2004, ka deklaruar si adresë banimi rrugën “\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, pasi kjo ka qenë adresa e banimit ku ka jetuar së bashku me prindërit e tij. Në këtë shtëpi ka jetuar derisa është blerë nga babai i tij K.K apartamenti po në \*\*\*, pallati nr. \*\*\*, kati \*\*\*, adresë që është deklaruar më pas në DPV. Në vitin 2004 kanë jetuar po në këtë apartament me qira në pritje të ndërtimit të pallateve të reja që ishin pranë apartamentit që u shit.

**37.2.** ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri<sup>54</sup>, ka konfirmuar se në datën 2.3.2000 babai i subjektit K.K e ka blerë<sup>55</sup> këtë pasuri nga shoqëria “Y.Y A.D & C.LTD” sh.p.k., për çmimin prej 56,000 USD dhe e ka shitur<sup>56</sup> në datën 3.5.2003 për çmimin prej 55,000 USD.

**37.3.** Sa më sipër, rezulton se kjo pasuri është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit rreth 3 vite para fillimit të ushtrimit të detyrës/funksionit të tij si prokuror (madje para fillimit të studimeve në shkollën e magistraturës).

#### *2) Periudha 2005 – 2013*

**37.4.** Nga verifikimi i DPV-ve për vitet 2005 – 2013 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi apartamentin e ndodhur në rrugën “\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, Tiranë.

**37.5.** Gjithashtu, konstatohet se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë ku është regjistruar në gjendjen civile, rrugën “\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, apartamenti \*\*\*, Tiranë.

**37.6.** Në përgjigjeje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se deklarimi në deklaratën “Vetting” si adresë e gjendjes civile: rrugën “\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, Tiranë, është bërë në momentin kur ai është martuar, për shkak të qëndrimit të përkohshëm në këtë adresë, pasi kjo është banesa e prindërve të tij, në të cilën kanë qëndruar përkohësisht pas martesës. Për periudhën 2009 – dhjetor 2012 kanë qëndruar në këtë banesë të prindërve të tij, të deklaruar më lart.

<sup>53</sup> Pyetësori nr. 3.

<sup>54</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2019.

<sup>55</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.3.2000.

<sup>56</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.5.2003.

**37.7.** Referuar kontratës së sipërmarrjes<sup>57</sup> së datës 14.12.2005, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit K.K ka porositur nga shoqëria “Y.Y A.D & C.LTD” sh.p.k. apartamentin nr. \*\*\*, në godinën \*\*\*, të ndërtuar nga kjo shoqëri, për çmimin 63,000 euro, dhe se pagesat do të kryheshin: (i) vlera 14,000 euro në datën 14.12.2005; (ii) vlera 4,000 euro në datën 23.12.2005, dhe (iii) vlera 45,000 euro do të sigurohej nga porositësi me kredi.

**37.8.** ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri<sup>58</sup>, konfirmon se në emër të babait të subjektit të rivlerësimit K.K figuron e regjistruar pasuria e llojit “apartament”, me sip. 152.3 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, pallati nr. \*\*\*, shkalla \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”, sipas kontratës së shitjes me kusht të datës 24.2.2006<sup>59</sup>, dhe në seksionin e kartelës së pasurisë “Seksioni i hipotekave, vendimeve të gjykatës, kufizimeve etj.” ka përshkrimin “Në favor të ‘Emporiki Bank’ për sigurimin e kredive kontratë hipoteke nr. \*\*\*, datë 10.3.2006”.

**37.9.** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie<sup>60</sup>, ndër të tjera, ka deklaruar se kjo pasuri është porositur nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.12.2005, nga babai i tij K.K, me çmim shitjeje 63,000 euro. Kjo shumë është paguar pjesërisht 45,000 euro, me kredi të marrë pranë “Emporiki Bank”, me datë disbursimi 23.3.2006, si dhe 18,000 euro është paguar cash sipas kësteve të kontratës. Në lidhje me burimin e të ardhurave të shumës 18,000 euro, sqaron se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.5.2003, babai i tij ka shitur apartamentin e ndodhur në \*\*\*, godina nr. \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, kati \*\*\*, me tre dhoma e një kuzhinë, me çmimin 55,000 USD dhe ka pasur gjendje cash. Po kështu ka pasur edhe të ardhura të tjera të ligjshme realizuara me punën e tij, si dhe një dëmshpërblim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të paligjshme në shumën 2,106,200 (dy milionë e njëqind e gjashtë mijë e dyqind) lekë të reja të paguara në datën 16.9.2005 nga Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale.

**37.10.** Në mbështetje të deklarimeve të bëra në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, subjekti, ndër të tjera, ka depozituar dokumentacionin provues i cili është vlerësuar nga Komisioni. Gjithashtu, nga verifikimi i DPV-së së vitit 2004 konstatohet se në seksionin/rubrikën “pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme” subjekti ka deklaruar shumën 35,000 USD, me shënimin “100 % babai im në datën 31.12.2004”.

**37.11.** Në analizë të të dhënave të mësipërme, si dhe nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, duket se kjo pasuri e blerë për çmimin 63,000 euro (apartamenti me sip. 153 m<sup>2</sup>, i ndodhur rrugën “\*\*\*\*”, godina \*\*\*, ndërtuar nga shoqëria “Y.Y A.D & C.LTD” sh.p.k.) si burim krijimi ka pasur të ardhurat e përfituara nga kredia bankare prej 45,000 euro të disbursuar nga “Emporiki Bank” në vitin 2006, si dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të mëparshëm (apartamenti i shitur në vitin 2003 në shumën 55,000 USD).

**38.** Komisioni ka hetuar edhe lidhur me pasuri të tjera në pronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit, për shkak të faktit se kanë pasur një ekonomi të përbashkët, kanë jetuar bashkërisht dhe vetë subjekti ka deklaruar adresa banimi pasuritë e prindërve të tij.

**38.1.** Apartament banimi me sip. 137 m<sup>2</sup>, godina \*\*\*, tek \*\*\*, Tiranë, i ndodhur në të njëjtën zonë me apartamentin e analizuar më lart.

<sup>57</sup> Kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.12.2005 (depozituar si provë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2).

<sup>58</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2019.

<sup>59</sup> Kontratë shitje me kusht nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.2.2006.

<sup>60</sup> Pyetësori nr. 3.

**38.2.** ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri<sup>61</sup>, informon se në emër të shtetasit K.K është e regjistruar pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe totale 137 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, godina \*\*\*, tek \*\*\*, Tiranë, e cila është blerë nga shoqëria “Y.Y A.C & D.LTD” sh.p.k.

**38.3.** Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja rezulton se kjo pasuri është regjistruar në emër të babait të subjektit të rivlerësimit K.K, bazuar në kontratën e shitjes<sup>62</sup> datë 18.2.2019, në përmbajtje të së cilës, ndër të tjera, palët kanë deklaruar se *blerësi i ka likuiduar shitësit çmimin e blerjes prej 6,500,000 lekësh jashtë kësaj zyre noteriale. Pala shitëse, pra shoqëria “Y.Y A.C & D.LTD” deklaron se e ka marrë të gjithë shumën totale të këtij apartamenti dhe është likuiduar totalisht përpara datës 30.12.2009.*

**38.4.** Referuar kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie dhe deklaratës noteriale<sup>63</sup> që e shoqëron atë, duket se blerësi e ka likuiduar çmimin e blerjes së kësaj pasurie prej 6,500,000 lekësh përpara datës 30.12.2009.

**38.5.** Në këtë kontratë përcaktohet se blerësi merr përsipër t’i paguajë shitësit shumat 52,000 euro dhe 132,000 lekë, të cilat do të paguhen *cash* nga blerësi, si vijon: (a) deri në datën 16.1.2009 shuma 43,000 euro; (b) deri në datën 14.2.2009 shuma 5,000 euro; dhe (c) deri në datën 29.4.2009 shuma 4,000 euro.

**38.6.** Shoqëria “Y.Y A.d & C.LTD” sh.p.k.<sup>64</sup>, ndër të tjera, informon se kjo pasuri është marrë në dorëzim nga blerësi (babai i subjektit) në datën 30.12.2009, dhe se bazuar në kopjet e mandatpagesave të dorëzuara, likuidimi i çmimit të blerjes është realizuar si vijon: (i) në datën 16.1.2009 është paguar shuma 43,000 euro; (ii) në datën 19.2.2009 është likuiduar shuma 5,000 euro; (iii) në datën 29.4.2009 është likuiduar shuma 4,000 euro; dhe (iv) në datën 1.6.2009 është likuiduar shuma 132,000 lekë. Pra, rezulton se likuidimi i çmimit prej 52,000 euro dhe 132,000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie është kryer deri në datën 1.6.2009.

**38.7.** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni duke i kërkuar të deklarojë<sup>65</sup>: (a) nëse mes shoqërisë ndërtuese dhe babait të tij ka pasur kontratë sipërmarrjeje/prenotimi etj., lidhur me këtë pasuri; (b) kur është marrë në dorëzim nga babai i tij kjo pasuri; (c) në momentin që është marrë në dorëzim kjo pasuri, kush e ka marrë në përdorim dhe kush ka banuar në këtë apartament; (ç) nëse ka banuar ai vetë në këtë apartament dhe, nëse po, a ka kryer shpenzime arredimi; (d) mbi mënyrën e kryerjes së pagesës (*cash* apo nëpërmjet sistemit bankar), si dhe periudhën/kohën e kryerjes së likuidimit të çmimit për blerjen e kësaj pasurie; (dh) mbi burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për blerjen e saj; (e) kush e përdor këtë pasuri aktualisht; si dhe (ë) mbi çdo të dhënë dhe dokumentacion tjetër që disponon lidhur me këtë pasuri – ka shpjeguar se *apartamenti është blerë nga babai i tij me kontratë premtim shitjeje datë 16.1.2009, i cili i ka deklaruar se si prind ka menduar që të blejë në një zonë të Tiranës, e cila nuk ka qenë e preferuar për shtresat e larta shoqërore (zona e \*\*\*, \*\*\*), dy apartamente, vlera e të cilave, në momentin e blerjes, ka qenë disa herë më e ulët se në qendër. Babai i tij K.K, ka punuar që nga viti 1993 dhe aktualisht vazhdon të punojë si avokat, ndonëse është në moshën 73 vjeç, duke paguar rregullisht detyrimet tatimore dhe taksat ndaj shtetit. Babai i tij është një avokat i suksesshëm dhe i njohur në fushën penale, ku ka kryer mbrojtje për vepra të rënda penale dhe për rezultatin e përfundimit të suksesshëm të gjykimit është shpërblyer nga klientët e tij. Të ardhurat e këtij apartamenti janë realizuar nga puna e prindërve të tij në vite. Kjo banesë është marrë në dorëzim nga prindërit e tij në datën 30.12.2009 dhe më pas është dhënë me qira deri në muajin shtator të vitit 2019. Aktualisht kjo banesë nuk është dhënë më me qira për shkak të situatës së pandemisë Covid-19. Prindërit e tij i posedojnë vetë të dy banesat.*

<sup>61</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2019.

<sup>62</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.02.2019.

<sup>63</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 18.2.2019.

<sup>64</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2021, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2021.

<sup>65</sup> Pyetësori nr. 4.



*Arredimi i shtëpisë është bërë nga babai pjesë-pjesë i thjeshtë, pasi ka qenë një banesë e dhënë me qira.*

**38.8.** Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti ka depozituar dokumentacion ligjor lidhur me këtë pasuri dhe se gjithashtu, në përgjigje të pyetësorëve të mëparshëm, ka depozituar dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e prindërve të tij ndër vite, i cili është vlerësuar nga Komisioni.

**38.9.** Në përfundim të hetimeve, Komisioni nuk konstaton gjetje që lidhin subjektin e rivlerësimit me këto pasuri apo dyshime të tjera.

### **Pasuritë e deklaruara veçmas nga personi i lidhur, znj. B.K**

**39. Pasuria e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë,** porositur në datën 21.9.2004 nga shoqëria “B.N” sh.p.k., me vlerë 39,000 euro, deklaruar 100 % në emër të personit tjetër të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. B.K. Personi i lidhur ka deklaruar se apartamenti është përfunduar në maj të vitit 2006.

**39.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie,** personi i lidhur ka deklaruar: (i) kredinë e marrë në “Alpha Bank” në datën 7.7.2005, në vlerën 2,500,000 lekë; (ii) kredinë e marrë nga “Fondacioni Besa” në datën 18.7.2006, në vlerën 500,000 lekë, (iii) të ardhura që dispononte familja e saj; si dhe (iv) të ardhura nga shitja e librave të botuara prej saj.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këto pasuri**

**40.** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI (pjesë e dokumentacionit që shoqëron deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, aneks 4/5) konstatohet se me kontratën e sipërmarrjes<sup>66</sup> të datës 21.9.2004, znj. B.K ka porositur nga shoqëria “B.N” sh.p.k., pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sip. 57 m<sup>2</sup> në objektin që do ndërtohej nga kjo shoqëri në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, për çmimin 39,000 euro.

**40.1.** Në këtë kontratë, plani i pagesave përcaktohet si vijon: (i) shuma 12,000 euro do t’i likuidohej sipërmarrësit me lidhjen e kontratës; (ii) shuma 11,000 euro brenda muajit shkurt të vitit 2005; (iii) shuma 12,000 euro do të likuidohej brenda muajit nëntor të vitit 2005; (iv) dhe diferenca tjetër e çmimit prej 4,000 euro do të likuidohej në momentin e dorëzimit të çelësave të apartamentit.

**40.2.** Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni në lidhje me prenotimin, shlyerjet e kësteve, burimin e krijimit të të ardhurave të përdorura për pagesën e kësteve, kohën e marrjes në dorëzim të apartamentit, lidhjen e kontratave përkatëse për furnizim me energji elektrike dhe ujë të pijshëm, për shpenzimet për arredim dhe për shfrytëzimin e kësaj pasurie para dhe pas vitit 2009, ndër të tjera, ka deklaruar se *mes tij dhe znj. B.K, përpara celebrimit të martesës, nuk ka ekzistuar bashkëjetesë, në kuptim të nenit 163 të Kodit të Familjes [...] Bashkëshortja e tij B.K është vetë subjekt rivlerësimi dhe ka dhënë shpjegime në procesin e Vetting-ut që është kryer ndaj saj [...], dhe se kjo pasuri nuk i përket atij dhe ai si subjekt nuk ka asnjë lidhje me të.*

**40.3.** Nga verifikimi i DPV-ve të depozituara, ndër vite, në ILDKPKI nga personi i lidhur, znj. B.K, konstatohet se:

---

<sup>66</sup> Kontratë sipërmarrje datë 21.9.2004, konfirmuar me dokumentin noterial vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., datë 21.9.2004.

- i. Në DIP-në e vitit 2004, personi i lidhur ka deklaruar kontratë sipërmarrjeje, datë 21.9.2004, për ndërtimin e një apartamenti, në vlerën totale 39,000 euro me sip. 57 m<sup>2</sup>, 100 % në emër të saj – pagesa kryhet me këste.
- ii. Në DIP-në e vitit 2005, personi i lidhur ka deklaruar se ka paguar gjatë vitit 2005 shumën 23,000 euro sipas kontratës, me kredinë e marrë.

**40.4.** Në vijim, rezulton se nuk deklaron as pagesa dhe as detyrim të mbetur ndaj shoqërisë “B.N” sh.p.k., që lidhet me pasurinë e prenotuar në vitin 2004. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga një tjetër trup gjykues për rivlerësimin e bashkëshortes së subjektit, rezulton se në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, ajo ka deklaruar se deri në datën 24.7.2006 ka shlyer tërësisht detyrimin prej 39,000 euro në favor të shoqërisë “B.N” sh.p.k.

**40.5.** Sa më sipër, në kushtet kur rezulton e provuar se kjo pasuri është krijuar nga personi i lidhur para lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit – deklaruar 100 % në emrin e saj – si dhe në konsideratë të faktit se personi i lidhur është vetë subjekt rivlerësimi për të cilin është kryer tashmë një proces i pavarur/i veçuar nga një tjetër trup gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ky trup gjykues vlerësoi të mos thellohet në analizimin e deklaramëve të bëra lidhur me këtë pasuri dhe mundësisë financiare për blerjen/krijimin e saj.

**40.6.** Personi i lidhur, znj. B.K, ka deklaruar se **zotëron ¼ e pasurive**, si vijon: (i) truall me sip. 300 m<sup>2</sup>, nga kjo 100 m<sup>2</sup> ndërtesë, ndodhur në \*\*\*, Berat, viti i krijimit 1997, ndërtuar nga prindërit, regjistruar në ZVRPP-në Berat, certifikatë për vërtetim pronësie, datë 11.5.2005; (ii) tokë arë me sip. 2,400 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Berat, përfituar me ligjin nr. 7501 “Për tokën”, regjistruar në ZVRPP-në Berat, certifikatë pronësie, datë 15.4.2011; (iii) tokë arë me sip. 3,850 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Berat, përfituar me ligjin nr. 7501, regjistruar në ZVRPP-në Berat, certifikatë pronësie datë 15.4.2011; dhe (iv) ullishte me sip. 275 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Berat, përfituar me ligjin nr. 7501, regjistruar në ZVRPP-në Berat, certifikatë pronësie, datë 15.4.2011.

**40.7.** Gjithashtu, personi i lidhur ka deklaruar se bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore<sup>67</sup> të datës 28.12.2016, për shkak se nëna e saj ka ndërruar jetë, përfiton edhe 1/3 e 1/4 pjesë të këtyre pasurive. Nga verifikimi i dokumentacionit justifikues ligjor të depozituar për këto pasuri<sup>68</sup>, rezulton se janë regjistruar në emër të babait të bashkëshortes së subjektit, z. B.K, disa vite para lidhjes së martesës me znj. B.K (madje para fillimit të detyrës nga vetë personi i lidhur). Në këtë këndvështrim, Komisioni vlerësoi të mos thellohet në verifikimin e mënyrës së fitimit dhe saktësisë së deklaramit të pjesës takuese nga personi i lidhur për këto pasuri.

### **Analiza financiare për vitet 2003 - 2016**

**41.** Bazuar në, dokumentacionin e administruar në dosje, deklaramet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur për çdo vit, për vitet 2003 – 2016, nga ku rezulton se vitet 2006, 2008, 2010, 2011 dhe 2012 paraqiten me balancë negative të fondeve, e konkretisht: (i) për vitin 2006, balanca negative e fondeve (-766,640 lekë); (ii) për vitin 2008, balanca negative e fondeve (-241,163 lekë); (iii) për vitin 2010, balanca negative e fondeve (-1,666,018 lekë); (iv) për vitin 2011, balanca negative e fondeve (-454,164 lekë); dhe (v) për vitin 2012, balanca negative e fondeve (-295,429 lekë).

**41.1.** Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e

<sup>67</sup> Dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.12.2016.

<sup>68</sup> Ndodhur në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2006, 2008, 2010, 2011 dhe 2012.

**41.2.** Komisioni vëren se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për rezultatet e analizës financiare për vitet 2006, 2008, 2010 dhe 2011 janë trajtuar si më sipër në këtë vendim, në vlerësimin e mundësisë së krijimit të likuiditeteve *cash* dhe në bankë, shlyerjen në vitin 2010 të pjesës së mbetur të kredisë së marrë nga personi i lidhur në “Alpha Bank”, si edhe kryerjen e pagesave për likuidimin e çmimit të apartamentit në Tiranë, gjatë vitit 2011.

**41.3.** Ndërsa, lidhur me rezultatet e analizës financiare për vitin 2012, Komisioni vlerëson se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve janë të karakterit deklarativ, dhe si të tilla, nuk do të merren në konsideratë.

### **Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

**42.** Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurisë dhe njëkohësisht kryerjen e shpenzimeve ndër vite.

**42.1.** Si përfundim, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, si dhe duke konsideruar edhe provat shkresore të administruara në dosje lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të bëra në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLI I FIGURËS**

**43.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ai ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

**43.1.** Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin<sup>69</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaramtën për kontrollin e figurës; dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar<sup>70</sup>.

**43.2.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

**43.3.** Në vijim, me shkresën nr. \*\*\*, datë 2.2.2021, Komisioni i kërkoi DSIK-së të përditësojë raportin e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ervin Karanxha, përderisa raporti pararendës kishte kryer verifikimin deri në datën 2.11.2017, kur i është bërë me dije Komisionit.

<sup>69</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017.

<sup>70</sup> Raport i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.4.2021, të KDZH-së.

**43.4.** DSIK-ja informon Komisionin<sup>71</sup> se për subjektin e rivlerësimit Ervin Karanxha disponohen të dhëna mbi përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës, etj. Nga vlerësimi i të dhënave rezulton se informacionet nuk janë sqaruar, dokumentuar apo thelluar më tej. Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Ervin Karanxha, gjykojnë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ të kryer ndaj këtij subjekti rivlerësimi<sup>72</sup>.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**44.** Trupi gjykues vlerëson se nga rrethanat e konstatuara nga grupi i punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, nuk rezultojnë se subjekti Ervin Karanxha ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se nuk u provua gjatë hetimit që subjekti i rivlerësimit të jetë në kushtet e nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës.

**44.1.** Komisioni vlerësoi të mos kryejë hetime të veçanta lidhur me figurën e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që vetë institucioni kompetent nuk ka dërguar të dhëna konkrete dhe se në Komision nuk kishte *indicie* specifike. Po ashtu, në këtë vlerësim, trupi gjykues ka vlerësuar se gjetjet mbi komponentët e tjerë të rivlerësimit janë të mjaftueshëm për arritjen e një konkluzioni përfundimtar për këtë subjekt rivlerësimi.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

**45.** Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, prej tetorit të vitit 2003 e aktualisht ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Raporti i mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale**

**45.1.** Ky raport<sup>73</sup> është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**45.2.** Në analizë të të dhënave mbi çështjet e evidentuara si të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe verifikimit të 5 dosjeve të shortuara për periudhën e rivlerësimit, konstatohet se prokurori Ervin Karanxha ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrin total në çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

**45.3.** Subjekti i rivlerësimit Ervin Karanxha kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese, u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat e aktet e nevojshme dhe konkluduar në një vendimarrje. Lidhur me njoftimet e vendimarrjeve, konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve. Gjithashtu, vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

<sup>71</sup> Raport nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2021.

<sup>72</sup> Raport i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\* , datë 13.4.2021, të KDZH-së.

<sup>73</sup> Raport nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020.

## Denoncimet e publikut të depozituara në Komision

**45.4.** Komisioni administroi dhe mori në shqyrtim 26 denoncime të depozituara nga publiku ndaj subjektit të rivlerësimit<sup>74</sup>, z. Ervin Karanxha. Denoncimet ngrenë pretendime mbi procedurat e ndjekura nga subjekti gjatë proceseve hetimore penale, vendimmarrjen, korrupsionin e mundshëm, etj.

**45.5.** Pasi shqyrtoi secilin prej denoncimeve, duke verifikuar edhe dokumentacionin e administruar në dosje lidhur me to, si dhe pasi vlerësoi dhe analizoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit në lidhje me këto denoncime, Komisioni arrin në përfundimin se për 22 (njëzet e dy) prej tyre<sup>75</sup> nuk vërehen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë *indicie* konkrete për Komisionin e që mund të merren në konsideratë në rivlerësimin e subjektit Ervin Karanxha.

**45.6.** Lidhur me këto denoncime, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht rrethanave mbi bazën e të cilave u arrit në konkluzionin e mësipërm lidhur me trajtimin e 22 denoncimeve, subjekti i rivlerësimit nuk është treguar bashkëpunues, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk dha shpjegime dhe nuk depozitoi dokumentacionin e kërkuar për çdo çështje të ngritur nga Komisioni në shqyrtimin e tyre, me dërgimin e rezultateve të hetimit. Ai nuk i dha vëmendjen e duhur denoncimeve dhe as nuk u përpoq të shpjegonte pozicionin e tij në ato çështje. Ky konstatim i trupit gjykues duhet të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**45.7.** Komisioni u ndal në veçanti dhe vlerësoi 4 denoncime, si vijon:

### a. Trajtimi i denoncimit nga shtetasi E.K<sup>76</sup> dhe denoncimit nga shtetasi F.O<sup>77</sup>

**a.1.** Nga verifikimi i ankesës së depozituar nga shtetasi E.K, vërehet se ai denoncon faktin se pas zhvillimit të procesit administrativ – për të cilin ka marrë vendim znj. B.K – ka depozituar kallëzim penal që lidhet me çështjen administrative, të cilin e ka trajtuar prokurori Ervin Karanxha (bashkëshorti i znj. B.K). Denoncuesi sqaron se znj. B.K (bashkëshortja e E. Karanxha) ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 9.4.2015, në gjykimin administrativ (çështja kundër ALUIZNI-t), i cili më pas ka bërë kallëzim penal kundër punonjësve të ALUIZNI-t. Çështja i është caktuar prokurorit Ervin Karanxha, i cili ka nxjerrë vendimin e datës 25.9.2018, për mosfillimin e procedimit në lidhje me materialin kallëzues të depozituar prej tij, regjistruar me nr. \*\*\*, të vitit 2018, duke argumentuar se konflikti është i një natyre administrative.

**a.2.** Nga verifikimi i ankesës së depozituar nga shtetasi F.O, Komision vëren se në të përmenden disa subjekte rivlerësimi, por se duket se nuk paraqiten fakte e rrethana konkrete për prokurorin Ervin Karanxha. Denoncuesi pretendon se ka depozituar disa kallëzime dhe një

<sup>74</sup> Denoncime të depozituara në Komision përpara mbylljes së hetimit administrativ dhe dërgimit të rezultateve të hetimit.

<sup>75</sup> (1) Ankesa nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2017, e shtetasit Z.R; (2) ankesat nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2017, dhe nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2018, e shtetasit A.E; (3) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2018, e shtetasit A.Ç; (4) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 2.5.2018, e shtetasit A.B; (5) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 9.5.2018, e shtetasit B.N; (6) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2018, e shtetasit R.I; (7) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2018, e shtetasit P.M; (8) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2018, e shtetasit S.Z; (9) ankesat nr. \*\*\* prot., datë 3.1.2019, dhe nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2020, e shtetasit A.A; (10) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 17.4.2019, e shtetasit E.L; (11) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2019, e shtetasit T.M; (12) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 19.12.2019, e subjektit P.D; (13) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2020, e shtetasit N.M; (14) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2020, e shtetasit B.A; (15) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2020, e shtetasit R.B; (16) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020, denoncim anonim; (17) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2020, e shtetasit J.B; (18) ankesat nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2020, dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2020, e shtetasit M.B; (19) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 13.1.2021, shtetasit K.M; (20) Ankesa nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2021, denoncim anonim dhe Ankesa e dërguar me postë elektronike (*e-mail*) datë 25.2.2021, e shtetasit H.Gj (ankesa me të njëjtin objekt); (21) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2021, e shtetasit Y.K; dhe (22) ankesa nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2021, e shtetasit E.F.

<sup>76</sup> Ankesa nr. \*\*\* prot., datë 14.6.2019.

<sup>77</sup> Ankesa nr. \*\*\* prot., datë 30.8.2019.

prej tyre është mbyllur nga prokurori Karanxha. Bashkëlidhur ka depozituar vendimin e pushimit të çështjes lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**a.3.** Referuar denoncimit dhe materialeve të dërguara bashkëlidhur tij, konstatohet se denoncuesi ka pasur një mosmarrëveshje administrative (me ALUIZNI-n dhe organe të tjera shtetërore, si palë të treta), e cila është shqyrtuar në rrugë gjyqësore. Gjithashtu, rezulton se pjesë e trupit gjyqësor që ka shqyrtuar çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit është edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. B.K (vendimi nr. \*\*\*, datë 23.1.2018, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë).

**a.4.** Denoncuesi ka bërë kallëzim kundër prishjes së ndërtimit të tij, duke pretenduar se kishte bërë tashmë kërkesë për legalizim. Sipas përshkrimit, referuar vendimit të pushimit, duket se prokurori, në vijim të hetimeve, nuk gjeti elementë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës ose të ndonjë vepre tjetër, dhe se gjithashtu në këtë vendim referon se (pjesë e paragrafit të fundit të faqes 5 të vendimit) *pretendimet e kallëzuesit në lidhje me prishjen e këtij ndërtimi janë trajtuar dhe duke u shqyrtuar civilisht në sistemin gjyqësor dhe, konkretisht, në gjykatat e shkallëve të para dhe ato të apelit.*

**a.5.** Pra, duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni për konfliktin administrativ dhe shqyrtimin e tij nga gjykatat civile/administrative.

**a.6.** Sa më sipër, pa i hyrë themelit të çështjeve, duket se subjekti i rivlerësimit në dy rastet e mësipërme ka qenë në kushtet e parashikuar në nenin 26 të Kodit të Procedurës Penale “Heqja dorë e prokurorit”, sipas të cilit ka pasur detyrim për të hequr dorë nga hetimet paraprake për këto çështje – për shkak se duket se ekzistojnë arsye njëanësie.

### **Qëndrimi i subjektit mbi gjetjet e evidentuara në trajtimin e këtyre dy denoncimeve**

**46.** Pasi Komisioni i kaloi barrën e provës, me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se: **i)** për sa i përket ankesës së shtetasit E.K, që lidhet me materialin kallëzues nr. \*\*\*, të vitit 2018, ka shpjeguar se për këtë çështje është dhënë dorëheqja nga ana e tij. Pas dorëheqjes është caktuar me ndjekjen e saj prokurore D.H, çështja penale ka marrë numrin e procedimit \*\*\*, të vitit 2019, dhe se në vijim kjo çështje është dërguar për pushim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**46.1.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se në hetimin paraprak të kryer për çështjen në fjalë ka përmbushur testin objektiv dhe subjektiv për ofrimin e garancive të mjaftueshme për të përjashtuar çdo lloj dyshimi legjitim në lidhje me paanshmërinë, duke argumentuar se gjithashtu ka marrë në kohë veprimin e heqjes dorë, pasi referuar dispozitave ligjore të nenit 4/2, të ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, parashikohet se: “[...] Për qëllimet e këtij ligji vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit [...], si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit [...]”.

**46.2.** Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se për arsye objektive nuk mund të depozitohet një kopje të fashikullit penal. Por, vërehet se bashkëlidhur prapësimeve ka depozituar në rrugë elektronike (me *e-mail*) kërkesën për heqjen dorë nga çështja në fjalë, dokument i cili duket se nuk është në formën e kërkuar nga ligji<sup>78</sup> dhe, si i tillë, nuk mund të konsiderohet tej çdo dyshimi të arsyeshem se është pjesë e fashikullit të dosjes penale.

---

<sup>78</sup> Duket se është një kopje e printuar në formatin word, pa firmën e subjektit të rivlerësimit, e pa protokolluar dhe e pa cikluar.

ii) Ndërsa, lidhur me materialin kallëzues për të cilin ka depozituar ankesë shtetasi F.O, pasi ka parashtruar rrethanat e çështjes dhe ka argumentuar mbi vendimmarrjen e tij, ka referuar se në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.1.2008, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë – të përmendur në materialin rezultatet e hetimit administrativ – sqaron se bashkëshortja e tij në atë periudhë ka qenë me punë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

### **Vlerësimi përfundimtar i Komisionit**

**47.** Komisioni vëren se, bazuar në nenin 26 të Kodit të Procedurës Penale prokurori ka për detyrë të heqë dorë kur ekzistojnë arsye njëanësie për rastet e parashikuara në nenin 17 të këtij Kodi. Në referim të gurmës “ë”, të nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale prokurori ka për detyrë të heqë dorë nga hetimi i çështjes kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

**47.1.** Në këtë këndvështrim, trupi gjykues çmon se në rastin kur personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka gjykuar çështje të natyrës administrative dhe është shprehur me vendim, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrë të heqë dorë nga hetimi i çështjes penale për fakte të kallëzuara që lidhen me rrethana të caktuara dhe për të cilat, në një kuptim, ka mbajtur qëndrim edhe bashkëshortja e tij në vendimin e dhënë.

**47.2.** Në vlerësim të Komisionit, me verifikimin e rrethanave të tilla, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që të paraqesë menjëherë kërkesën e tij për heqje dorë nga hetimi i çështjes. Si rrjedhojë, trupi gjykues çmon se nuk janë bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti se në rastin e kallëzimit të bërë nga shtetasi E. K ka marrë në kohë veprimin e dorëheqjes, për sa kohë nuk ishte marrë vendimmarrja përfundimtare për këtë kallëzim.

**47.3.** Përpos faktit se subjekti pretendon se ka hequr dorë nga hetimi i çështjes – pasi më parë ka vendosur për mosfillimin e procedimit penal dhe në vijim është urdhëruar nga gjykata për regjistrimin e procedimit – gjithashtu nga verifikimi i kërkesës së heqjes dorë të depozituar nga vetë subjekti (vlerësuar me rezervë) duket se arsyet e heqjes dorë paraqiten me pretendimet e kallëzuesit në lidhje me paanësinë e prokurorit, si dhe për shkak të caktimit të tij në detyrën e drejtuesit të seksionit.

**47.4.** Lidhur me konstatimin e bërë nga Komisioni – në shqyrtim të denoncimit të bërë nga shtetasi F.O – subjekti ka pretenduar se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit i përmendur në materialin rezultatet e hetimit administrativ, referuar si akti që e vendoste subjektin përballë kushteve të papajtueshmërisë, është marrë në një kohë që bashkëshortja e tij ka qenë me funksion gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

**47.5.** Në vlerësim të pretendimit të subjektit, Komisioni vëren se në materialin rezultatet e hetimit administrativ është bërë lapsus në shënimin e vitit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, pasi gabimisht është shënuar vitit 2008, ndërkohë që vendimi është marrë në vitin 2018.

**47.6.** Gjithsesi, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit është njohur me materialet e hetimit administrativ të kryer ndaj tij, përfshirë edhe denoncimin e shtetasit F.O – pjesë e të cilit ka qenë edhe kopje e vendimit nr. \*\*\*, datë 23.1.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë – trupi gjykues vlerëson se minimalisht subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur në vlerësimin me përgjegjësi dhe seriozitet të gjetjeve të pasqyruara nga Komisioni me dërgimin e rezultateve të hetimit, apo në të kundërt, ka dashur të evitohet shpjegimet e tij, në përpjekje për të shmangur veten nga përgjegjësia ligjore që lidhet me këtë rast.

**47.7.** Si konkluzion, trupi gjykues çmon se hetimet e kryera për dy kallëzimet e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e cenimit të paanësisë, të etikës e vlerave profesionale, në kuptim të nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **b. Trajtimi i denoncimit të subjektit “U.Sh.K.K.”<sup>79</sup>**

**48. Objekti/përshkrimi i ankesës** – nga verifikimi i këtij denoncimi, duket se në një mosmarrëveshje civile me Unionin si palë, përmbaruesi, sipas këtij të fundit, filloi veprime përmbarimore të kundërligjshme (pretendohet se filloi ekzekutimin e detyrueshëm pa njoftim dhe skadimin e afatit për zbatimin vullnetar), duke u shkaktuar atyre dëm. Më 27.11.2018, “U.Sh.K.K.” ka paraqitur një kallëzim penal kundër përmbaruesit për shpërdorim detyre (neni 248 i Kodit Penal) dhe vjedhje përmes shpërdorimit të detyrës (neni 135 Kodit Penal). Më 18.1.2019 ata u njoftuan për vendimin e prokurorisë (prokurorit Ervin Karanxha), të datës 27.12.2018, për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2018. Duket se “U.Sh.K.K.” ka bërë ankim kundër këtij vendimi, por nuk ka asnjë informacion mbi rezultatin.

**48.1.** Për sa më sipër, Komisioni konstaton se me anë të këtij denoncimi, shoqëria “U.Sh.K.K.” pretendon se:

1) Vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është marrë pa kryer ndonjë hetim ose verifikim; në arsyetimin e prokurorit nuk tregohet nëse neni 290 i Kodit të Procedurës Penale (rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit) dhe vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 2/2013, janë marrë parasysht; pretendimet e kallëzimit penal nuk janë sqaruar.

2) Ka marrë vendim në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 327 e vijues (sipas Kodit të Procedurës Penale me ndryshimet e fundit), ku normohet faza e përfundimit të hetimeve dhe procedimi me dërgimin e vendimit të pushimit në gjykatë. Sipas denoncuesit, nëse prokurori do kishte kryer hetime, do arrinte një përfundim të ndryshëm nga ato me bazë në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale.

3) Kallëzimi penal është depozituar prej tyre në datën 27.11.2018, ndërsa vendimi i mosfillimit është marrë më 27.12.2018 dhe i është përcjellë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2019 (komunikuar më 23.1.2019), pra rreth 1 muaj me vonesë.

Pra, denoncuesi pretendon se vendimi i mosfillimit është marrë jashtë afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, ku përcaktohet se: *“Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit”*.

Gjithashtu, denoncuesi pretendon se në përputhje me pikën 2 të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale prokurori ka pasur detyrimin t'i njoftonte menjëherë për vendimin e mosfillimit, ndërkohë që ata, në cilësinë e kallëzuesit, janë njoftuar rreth 1 muaj me vonesë.

4) Vendimi i prokurorit nuk është i qartë, është i paarsyetuar dhe i pakuptueshëm.

5) Ka proceduar në papajtueshmëri të plotë, pasi ka shprehur mendimin e tij në një tjetër procedim – çështje penale të lidhur me këtë çështje (kallëzimin e U.SH.K.K, me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.10.2018, ku ka vendosur mosfillim procedimi). Ata pretendojnë se, në rast se do të ishin thirrur, do të kishin kërkuar përjashtimin e tij.

6) Nuk ka hetuar nëse kallëzuesit i ka ardhur dëm, pra pasojat e ardhura nga veprimet përmbarimore të përmbaruesit. Ata pretendojnë se janë dëmtuar nga veprimet e këtij përmbaruesi gjyqësor.

**48.2.** Pas analizimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë denoncim – me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – Komisioni vëren se ai ka parashtruar rrethanat e çështjes dhe ka argumentuar lidhur me vendimmarrjen e tij, por se nuk ka dhënë shpjegime për pretendimet e ngritura nga denoncuesi, të referuara si më sipër. Subjekti ka deklaruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* akti, datë

<sup>79</sup> Ankesa nr. \*\*\* prot., datë 6.2.2019.



23.4.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, të vitit 2018, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, por nga ana tjetër nuk e ka vendosur këtë vendim në dispozicion të Komisionit.

**48.3.** Si përfundim, nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi dhe materialeve bashkëlidhur tij, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë dhe të provojë të kundërtën e pretendimeve të ngritura në këtë denoncim, të pasqyruara si gjetje në materialin rezultatet e hetimit administrativ. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se ai ka demonstruar minimalisht mangësi të theksuara të njohurive ligjore nëpërmjet rolit të tij pasiv në kryerjen e veprimeve hetimore e në funksion të zbardhjes së çështjes. Problematikat e hasura në këtë procedim konsiderohen nga trupi gjykues si serioze dhe të papranueshme, referuar edhe eksperiencës dhe përvojës së prokurorit. Rrethanat e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e defekteve në drejtim të aspekteve ligjore, në kuptim të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e magjistratit”.

### **c. Trajtimi i denoncimit nga shtetasi A.H<sup>80</sup>**

**49.** Nga verifikimi i kësaj ankese, konstatohet se denoncuesi hedh dyshime dhe ngre pretendime mbi veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Ervin Karanxha, për tri çështje penale.

**49.1.** Për njërin nga rastet, denoncuesi parashtron se në vendimin e Komisionit për subjektin e rivlerësimit, z. Sh.K, referohet një çështje penale, ku pretendohet për kryerjen e veprimeve të dyshimta nga prokurori Ervin Karanxha.

**49.2.** Pasi u verifikua vendimi i Komisionit me nr. 80, datë 23.11.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Sh.K, rezulton se pretendimet e denoncuesit, lidhur me veprimet dhe qëndrimin e mbajtur nga prokurori Karanxha, i përkasin shqyrtimit të dosjes së procedimit penal me nr. \*\*\*, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298 i Kodit Penal, të transferuar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda<sup>81</sup>.

**49.3.** Nga verifikimi i kësaj dosjeje hetimore, duket se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka kryer veprime hetimore të kufizuara gjatë periudhës tetor 2013 – nëntor 2014.

**49.4.** Nga shqyrtimi i dosjes së fashikullit penal vërehen disa veprime të dyshimta të kryera nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, si:

**i.** Brenda një jave nga caktimi i çështjes, subjekti i rivlerësimit i kërkuar gjykatës kompetente që për personat nën hetim të ndryshonte masën e sigurisë nga “arrest në burg” (dhënë nga Krimet e Rënda) në “arrest në shtëpi”.

**ii.** Ka urdhëruar, brenda 24 ditësh nga caktimi i çështjes, kthimin e tre telefonave celularë dhe të automjetit të sekuestruar të njërit prej personave nën hetim (pikërisht H.M.), me motivacionin “*nuk janë të përshtatshme si prova materiale dhe nuk kanë lidhje me veprën penale*”. Vihet gjithashtu në dukje fakti se përfaqësuesi ligjor i shtetasis H. M. kishte kërkuar rikthimin e dy telefonave celularë të sekuestruar, duke pretenduar se nuk i përkisnin personit nën hetim (H. M.), por familjarëve të tij. Ndërkohë, rezulton se këta telefona u sekuestruan nga Prokuroria e Krimeve të Rënda në cilësinë e provës materiale, si mjete komunikuese për organizimin e ndihmës ndaj personave për kalimin e paligjshëm të kufirit jashtë shtetit dhe të përdorura personalisht nga i hetuari. Edhe automjeti i kthyer u sekuestrua nga Krimet e Rënda, bazuar në dyshimin se automjeti ishte përdorur për transportim, në kuadrin e veprimtarisë

<sup>80</sup> Ankesa nr. \*\*\* prot., datë 4.4.2019.

<sup>81</sup> Komisioni administroi kopje të njësuar me origjinalin të dosjes së plotë të këtij procedimi penal, të marrë nga dosja e administruar në Komision, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Sh.K.

kriminale. Nuk kuptohet cili ka qenë shkaku dhe urgjenca e heqjes së sekuestros dhe e kthimit të tyre, pasi ata përbënin mjetet nëpërmjet të cilëve konsumohej vepra penale në fjalë.

**iii.** Shtyrjen në çdo 3 muaj<sup>82</sup>, nga tetori i vitit 2013 deri në dhjetor të vitit 2014, të afatit për kryerjen e hetimit, me arsyetimin se ishte e nevojshme të merreshin dëshmi dhe të përkthehej në frëngjisht letërporosia e çështjes. Në dosje u gjetën 57 faqe të përpiluara në gjuhën frënge nga autoritetet franceze, ndërsa letërporosia dhe përkthimi i saj kishin qenë përkthyer më parë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.

**iv.** Subjekti, në cilësinë e prokurorit të çështjes, i ka kërkuar gjykatës një dënim në minimumin e parashikuar nga ligji për këtë akuzë – dhënien e ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit, në bashkëpunim, që është 5 vjet (ligji parashikon dënim maksimal prej 10 vjetësh).

**49.5.** Komisioni vëren se shkaku i kësaj kërkesë minimale, veç të tjerash, është shpjeguar nga subjekti i rivlerësimit, me faktin e pendimit të thellë nga ana e të pandehurit/ve (pendim ky që nuk rezulton të jetë shprehur apo pasqyruar nga asnjë dokument të dosjes, përkundrazi, për sa u përket akteve në dosje, nga dokumentacioni i paraqitur nga përfaqësuesit ligjorë të personave nën hetim/të akuzuar, rezulton e kundërta).

**49.6.** Konstatohet se arsyetimi i prokurorit për kërkesën e minimumit bazohej edhe në moshën e re e të akuzuarve, por kjo është e vështirë të kërkohej pasi rezulton se katër prej tyre ishin midis moshës 38 - 47 vjeç, dhe vetëm njëri prej tyre ishte 27 vjeç. Një tjetër arsye pse u kërkua minimumi i dënimit minimal ishte fakti që të akuzuarit nuk ishin dënuar më parë. Ndërsa ka rezultuar se shtetasi H. M. kishte qenë i dënuar në vitin 2011 për falsifikim monedhash në bashkëpunim.

**49.7.** Gjithashtu, vërehet se provat që subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur kërkesës për gjykim përmbajnë pothuajse vetëm rezultatet e veprimeve hetimore të ndërmarra nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Pra, rezulton se veprimet hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit kanë qenë pasive dhe jo efektive.

**49.8.** Si konkluzion, pas analizimit të këtij denoncimi, shqyrtimit të materialeve të fashikullit penal që lidhet me të, si dhe pas vlerësimit objektiv të shpjegimeve të dhënave nga subjekti i rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni vlerëson se ai ka demonstruar minimalisht mangësi të njohurive të ligjit për shkak të rolit të tij pasiv dhe jo efikas në drejtim të veprimtarisë hetimore në funksion të hetimeve të kryera, kërkesave të bëra për ndryshimin e masës së sigurimit personal, vendimet për kthimin e sendeve të sekuestruara, kërkesës për gjykim dhe konkluzioneve përfundimtare të paraqitura prej tij lidhur me këtë procedim penal, rrethana për të cilat subjekti duhet të kishte ushtruar kujdes dhe vëmendje të posaçme. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar rol pasiv në drejtim të veprimtarisë hetimore në funksion të zbardhjes së çështjes, si dhe vënien para përgjegjesisë ligjore të autorëve.

**49.9.** Trupi gjykues çmon se rrethanat e mësipërme e vendosin subjektin në kushtet e defekteve të rënda në drejtim të aspektit të njohurive ligjore të cilat në vlerësim të trupit gjykues janë bërë në mënyrë të qëllimshme nga subjekti i rivlerësimit, vlerësuar kjo edhe nga përvoja dhe eksperiencia e tij, duke e vendosur atë në kushtet e defekteve të dukshme në drejtim të aspektit të njohurive ligjore, në kuptim të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e magjistratit”.

**49.10. Në konkluzion** të vlerësimit të *indicieve* dhe të dhënave të rezultuara nga hetimi që lidhen me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mangësi serioze të indikatorit të arsyetimit ligjor, në kuptim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, dhe njëkohësisht mangësi të theksuara në aftësitë e tij organizative, sipas nenit 74

<sup>82</sup> Çështja u regjistrua në datën 1.10.2013. Rezulton se janë miratuar këto shtyrje të afatit të hetimeve: nga data 26.10.2013 - 26.1.2014; nga data 25.1.2014 - 25.4.2014; nga data 25.4.2014 - 25.7.2014; nga data 25.7.2014 - 25.10.2014; nga data 25.10.2014 - 31.12.2014. Ndërsa në datën 13.11.2014 subjekti i rivlerësimit u shpalli akuzat personave të akuzuar.

të ligjit nr. 96/2016. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në respektimin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, në kuptim të nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Këto konkluzione, duke qenë se lidhen me kriteret e vlerësimit të magjistratëve sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, kriteret të cilat urdhërohen të përdoren nga organet e rivlerësimit edhe për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit të nenit 44, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën, e çojnë trupin gjykues të Komisionit në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, për shkak të këtyre mangësive në indikatorët e kriterit të aftësisë profesionale, sipas parashikimeve të nenit E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, gjatë ushtrimit të profesionit ka demonstruar gjykim të dobët, që ka sjellë gjithashtu shkelje të të drejtave të palëve në proceset gjyqësore të trajtuara prej tij, në nivel të tillë që shihen të pamundura të riparohen nëpërmjet programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës. Për të gjitha sa arsyetohet më lart, subjekti konsiderohet se është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës së gjyqtarit dhe se ndaj tij duhet të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

## V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

**50.** Gjatë periudhës së rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka kontaktuar me subjektin me qëllim njohjen me të dhënat përkatëse, si dhe vlerësimin e kërkesave të tij. Pas dërgimit të rezultateve të hetimit (dërguar subjektit në datën 12.5.2021), z. Ervin Karanxha ka bërë disa kërkesa të njëpasnjëshme për shtyrjen e afatit për dorëzimin e shpjegimeve, e më tej ka kërkuar përjashtimin e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues, megjithëse ishte njohur me përbërjen e tij rreth dy vite më parë e kishte konfirmuar lidhur me të (në datën 15.3.2019).

**50.1.** Në vijim, subjekti i rivlerësimit është njoftuar nga Komisioni lidhur me kërkesat e tij (të cilat janë trajtuar në mënyrë të detajuar më lart në këtë vendim) dhe është ftuar në një seancë dëgjimore në datën 23.6.2021, ora 12:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*).

**50.2.** Për subjektin rivlerësues kanë rezultuar edhe disa përpjekje të tjera për shtyrje të procesit të rivlerësimit ndaj tij, të cilat, në vlerësim të trupit gjykues, nuk janë marrë në konsideratë, pasi nuk kishin shkaqe ligjore të përligjura. Ky informacion është vlerësuar nga Komisioni se nuk mund të bëhet publik për shkak të klasifikimit ligjor.

**50.3.** Në seancën dëgjimore të datës 23.6.2021 subjekti i rivlerësimit nuk ishte prezent. Ecuria e seancës dëgjimore, si dhe të seancave të tjera në vijim janë relatuar në mënyrë të detajuar në kreun II të këtij vendimi. Gjatë seancave dëgjimore subjekti rivlerësimit nuk është paraqitur vetë por ka ardhur në seancën e caktuar për shpalljen e vendimit. Gjatë seancave dëgjimore përfaqësuesit e subjektit kanë paraqitur një akt përfaqësimi konfuz dhe kontradiktor, gjithashtu kanë paraqitur kërkesë për shtyrje të seancës dëgjimore, në vijim kërkesa të njëpasnjëshme për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues, si dhe për përjashtim të të gjithë trupit gjykues. Po ashtu, vetë subjekti i rivlerësimit ka qenë prezent në seancën e datës 7.7.2021, të caktuar për shpalljen e vendimit dhe ka kërkuar të dëgjohet, por trupi gjykues ka vijuar me shpalljen e vendimit (sipas parashikimit), duke vlerësuar se vetë subjekti nuk ka dashur të dëgjohet në një seancë dëgjimore publike dhe se ka pasur të gjitha mundësitë për t'u dëgjuar nëse do të kishte dashur diçka të tillë. Ajo që konstatohet lehtësisht nga analiza e këtyre kundërshtive e sjelljeve të njëpasnjëshme është se ato kanë ardhur e janë kryer për shkak të vështirësisë së subjektit të rivlerësimit për t'u përballur e provuar të kundërtën e gjetjeve të Komisionit. Trupi gjykues vlerëson se të gjitha sjelljet e subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesve të tij ligjorë janë përpjekje për të prezantuar para organeve të rivlerësimit një situatë faktike që nuk i përgjigjet realitetit e që del jashtë kontekstit të rivlerësimit të kryer ndaj tij, e rezultateve konkrete të relatuara mbi hetimin administrativ dhe që tenton ta deformojë atë në funksion të prodhimit të të dhënave që do të favorizonin subjektin përgjatë procedurës së rivlerësimit.

**50.4.** Mënyra se si subjekti i rivlerësimit është sjellë gjatë procesit të rivlerësimit (në fazën finale të përmbylljes së tij) ka vënë në vështirësi trupin gjykues për zhvillimin e një procesi efikas, të shpejtë e transparent, që bie ndesh me detyrimin ligjor që buron nga neni 48 i ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se bashkëpunimi i subjektit të rivlerësimit gjatë procesit është një faktor që konsiderohet në vetë zbatimin ose jo të konkluzioneve për këtë proces.

**50.5.** Në vijim të këtij arsytimi, trupi gjykues çmon se sjellja e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ nuk ka qenë bashkëpunuese dhe, si e tillë, e ka vështirësuar punën e vetë organeve në kryerjen e procesit të rivlerësimit. Kundërshtitë dhe kërkesat e njëpasnjëshme gjatë procesit, e sidomos në fazën finale të përmbylljes së tij, konstatohen se kanë qenë një mënyrë sjelljeje e qëllimtë, e cila ka synuar të shtyjë procesin apo ta zgjasë atë në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me detyrimin ligjor që kanë subjektet për të qenë të vërtetë, të saktë e efikasë përgjatë këtij procesi. Trupi gjykues i Komisionit çmon se kjo sjellje duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit arrihet në konkluzionin se një sjellje e tillë ndaj një procesi kaq të rëndësishëm jo vetëm për jetën profesionale të subjekteve, por edhe të mirëfunksionimit të vetë sistemit të drejtësisë e shtetit të së drejtës në vend, cenon besimin e publikut te funksionari që e kryen atë, në një mënyrë të parikuperueshme nëpërmjet ndonjë programi trajnimi në Shkollën e Magjistraturës.

**50.6.** Në vlerësim të trupit gjykues, edhe vetëm kjo qasje e sjellje ndaj procesit të rivlerësimit do të përbushte një nga kushtet e parashikuara për shkarkim nga detyra, atë të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

## **VI. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

**51.** Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe mori në shqyrtim të gjitha provat e parashtruara prej tij, vlerësoi sjelljen e tij përgjatë procesit të rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- a. nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. është konkluduar i përshtatshëm në vlerësimin e figurës;
- c. është i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale për vazhdimin e detyrës së prokurorit;
- d. nuk u tregua bashkëpunues gjatë procesit të hetimit të kryer ndaj tij, si dhe me veprimet e mosveprimet e tij në mënyrë të përsëritur ka rezultuar se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

**51.1.** Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues, mbështetur në konkluzionet e mësipërme lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, kontrollin e kriterit të aftësive profesionale e vlerësimin tërësor të procedurave të rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, gjendet në kushtet e parashikuara nga pikat 1 e 3 të nenit D, pika 4 e nenit E të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nga pikat 3, 4 e 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 7.7.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Anëtare**

**Pamela QIRKO**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*